

# Përfshirja efektive e refugjatëve

Qasje pjesëmarrëse për  
profesionistët në nivelin vendor



# 1 | MANUAL

# FALËNDERIME

Ky manual është komisionuar nga Byroja Rajonale e UNHCR-së për Evropën dhe është zhvilluar në bashkëpunim me Grupin e Politikave të Migracionit.

Është shkruar nga :

Carmine Conte me mbështetjen e Alexander Wolffhardt, Grupi i Politikave të Migracionit;  
me udhëzime teknike të ofruara nga një ekip shumëfunksional në UNHCR dhe të dhëna nga pjesëmarrësit për testimin dhe vlefshmërinë në terren në shtatë vende të Evropës.

Një falënderim i veçantë shkon për koordinatorët kombëtarë në Bullgari, Finlandë, Greqi, Itali, Maltë, Poloni dhe Serbi:

Bistra Ivanova (Multi Kulti Collective)

Sari Vanhanen (Instituti i Migracionit i Finlandës)

Konstantinos Vlachopoulos (Fondacioni Helen për Politikën Evropiane dhe të Jashtme - ELIAMEP)

Gaia Testore (Studiues dhe Konsulent i Pavarur)

Jean-Pierre Gauci, Bethany Wilkes dhe Sonia Marcantonio (Fondacioni Njerëz për Ndryshim)

Renata Stefańska (Qendra për Kërkimet mbi Migracionin, Universiteti i Varshavës)

Gordana Grujić dhe Vladimir Petronijević (Grupa 484)

## KOLOFON

Fotografimi:

© UNHCR/Will Swanson

© UNHCR/Andrew McConnell

Shutterstock

Faqosja: dagmarvanschaik.nl

2

© UNHCR dhjetor 2021

# PËRMBAJTJA E LËNDËS

<b>1.PARATHËNIE</b>	<b>4</b>
<b>2.HYRJE</b>	<b>6</b>
<b>3.STRUKTURA E PAKETËS SË INSTRUMENTEVE</b>	<b>8</b>
<b>4.SI TË PËRDORET KJO PAKETË INSTRUMENTESH?</b>	<b>10</b>
<b>5.CILAT JANË FUSHAT KRYESORE TË QASJES GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ INTEGRIMIT?</b>	<b>12</b>
5.1 Qartësia rreth mbështetjes së nevojshme- vlerësoni vazhdimisht nevojat, jini të vetëdijshëm për pengesat e lidhura me aksesin dhe përshtatini shërbimet në bazë në komenteve dhe vlerësimeve të rregullta	
5.2 Sigurimi i ofrimit të mbështetjes për nevojat e të gjithëve – integrimi i shërbimeve tuaja në mënyrë që grupe të ndryshme të gëzojnë akses të barabartë dhe mbështetje sipas nevojës	
5.3 Krijimi i shërbimeve për kuadrin afatgjatë – përdorni perspektivën e përfshirjes afatgjatë përtej fazës së pritjes dhe e integrimit të hershëm	
5.4 Puna jo vetëm për njerëzit, por edhe bashkë me ta – përfshijini refugjatët në planifikim, zbatim dhe vlerësim, vlerësoni komentet e tyre dhe mbajini ata të informuar	
5.5 Përfshirja e komuniteteve vendore dhe mbështetja e vullnetarizmit – mobilizoni burimet e shoqërisë pritëse dhe nxisni besimin dhe identifikimin pozitiv	
5.6 Përpjekje për mbështetje gjithëpërfshirëse për integrim – Lidhuni dhe koordinohuni me ofruesit e tjerë dhe plotësoni mangësitë në sistem	
<b>6. LISTA GJITHPËRFSHIRËSE E KONTROLLIT</b>	<b>67</b>
<b>7.TREGUESIT PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË PRAKTIKAVE TË INTEGRIMIT</b>	<b>68</b>
<b>8.GLOSAR</b>	<b>72</b>
<b>9.VLERËSIMI MBIMANUALIN</b>	<b>76</b>

# 1. PARATHËNIE

Ajo që ndodh në nivel lokal ka rëndësi për integrimin efektiv dhe përfshirjen e refugjatëve në komunitet.

Që qytetet janë inkubatorë të novacionit dhe praktikave të mira në mbështetje të mbrojtjes së refugjatëve është treguar nga angazhimet për të zbatuar Paktin Global për Refugjatët. Në të vërtetë, se ku lëvizin refugjatët dhe si përfshihen ata në komunitetet pritëse varet nga vizioni, bashkëpunimi dhe angazhimi i kryetarëve të bashkive, bashkive dhe grupeve vendore. Autoritetet vendore shpesh tregojnë solidaritet bujar me refugjatët dhe migrantët duke 'u mbështjellë' rreth tyre dhe duke njohur kontributin e tyre të pasur dhe të larmishëm. Komunitetet vendore gjithashtu mund të jenë të dhembshur në përgjigje të persekutimit, humbjes dhe tjetërsimit kulturor të atyre që janë zhvendosur nga konflikti dhe dhuna.



Ky Manual është hartuar me Grupin e Politikave të Migracionit dhe synon të japë udhëzime praktike për aktorët lokalë dhe t'i frymëzojë më tej ata për t'i përfshirë refugjatët.

Qëllimi ynë ishte të krijojmë një paketë instrumentesh që bazohet te përvojat praktike të autoriteteve bashkiake dhe aktorëve lokalë për përkthimin e politikave kombëtare në zgjidhje të tilla si strehimi i përshtatshëm, aksesimi në dokumentacion dhe përfshirja sociale dhe ekonomike. Këto zgjidhje funksionojnë më mirë kur refugjatët përfshihen plotësisht në hartimin dhe zhvillimin e tyre. Refugjatët sjellin një mori aftësish, përvojë dhe gatishmëri për të kontribuar në komunitetet e tyre të reja. Ne e dimë se pjesëmarrja e refugjatëve në vendimmarrje ndihmon për ndërtimin e besimit përgjatë ushtrimit të të drejtave themelore dhe nxitjes së ndjenjës së përkatësisë dhe besimit në komunitetet pritëse. Qasjet pjesëmarrëse çojnë në politika më të zgjuara dhe programe më me ndikim. Megjithatë, menaxhimi i pjesëmarrjes efektive të zonave të ndryshme mund të jetë sfidues, veçanërisht kur plotësohen nevojat e refugjatëve për hartimin e projektit. Ky mjet është krijuar për të ndihmuar autoritetet vendore të bëjnë pikërisht këtë gjë.

Paketa e instrumenteve bazohet te përvoja prej disa dekadash e UNHCR-së dhe partnerëve tanë, si edhe te eksperimentimi me qasjet pjesëmarrëse. Por kjo paketë instrumentesh është e ndryshme. Ajo flet drejtpërdrejt për sfidat specifike të kryetarëve të bashkive, administratorëve të qytetit dhe ofruesve të shërbimeve vendore lidhur me pritjen dhe përfshirjen e refugjatëve dhe emigrantëve. Ne kemi përdorur gjuhë të thjeshtë për t'u kuptuar dhe kemi theksuar praktikën e mira për të frymëzuar novacionin dhe kreativitetin. Ne kemi zhvilluar gjithashtu tregues për të matur progresin, për të vlerësuar ndikimin dhe për të korrigjuar kursin atëherë kur është e nevojshme.

Ky botim është krijuar në bashkëpunim me autoritetet vendore, ofruesit e shërbimeve, shoqërinë civile dhe organizatat e udhëhequra nga refugjatët në të gjithë Evropën. Ai u testua në terren në disa vende dhe kontekste dhe u modifikua në përputhje me rrethanat. Ne u inkurajua nga entuziazmi dhe angazhimi me mjetin, i cili shpresojmë të jetë i dobishëm për profesionistët kudo që ata ndodhen. Ne gjithashtu shpresojmë se ky do të jetë një udhëzues "i gjallë" dhe do t'ju inkurajojë të ndani projekte, përvoja dhe ide të mira për përsëritjet e ardhshme të tij.

Gillian Triggs - Ndihmës Komisioneri i Lartë i UNHCR-së për Mbrojtjen



## 2. HYRJE

Përfshirja e azilkërkuesve të sapoardhur, refugjatëve, migrantëve dhe personave pa shtetësi është shfaqur si një prioritet kyç për kryetarët e bashkive, autoritetet vendore, shoqëritë civile vendore dhe ofruesit e shërbimeve. Ndërsa politikat kombëtare krijojnë një kornizë të gjerë politikash, janë autoritetet vendore ato që përballen me detyrën shpeshherë të frikshme për t'i kthyer këto politika në veprim dhe për të gjetur zgjidhje praktike. Kompakti Global për Refugjatët<sup>1</sup> e njuh integrimin dhe përfshirjen si një përgjegjësi të përbashkët dhe bashkitë, sektori privat dhe organizatat vendore janë shfaqur si agentë thelbësorë të novacionit dhe partnerë kryesorë të UNHCR-së. Suksesi ose dështimi për të arritur një përfshirje ose integrim efektiv në nivel vendor mund të ushtrojë ndikim mbi vendimmarrjen e ardhshme për azilin, zhvendosjen dhe rrugët plotësuese. Prandaj, është e domosdoshme që ta bëjmë siç duhet këtë detyrë.

Ndërsa numri i nismave të integritit dhe përfshirjes është shtuar që nga piku i mbërritjeve në vitin 2015/6, aktorët lokalë dhe autoritetet komunale kanë pak udhëzime praktike se si shërbimet dhe praktikatat e tyre mund të përshatën me situatën specifike dhe nevojat për mbrojtje të azilkërkuesve dhe refugjatëve, migrantë dhe persona pa shtetësi. Pjesëmarrja është thelbësore për hartimin e projekteve dhe identifikimin e korrigjimit të nevojshëm të drejtimit të marrë, por mund të jetë sfiduese për t'u organizuar dhe

për t'u mbajtur me kalimin e kohës. Të kuptosh nevojat e ndryshme të refugjatëve<sup>1</sup> dhe migrantëve sipas moshës, gjinisë, kulturës, fesë, aftësive të kufizuara ose faktorëve të tjerë dhe krijimi i programeve që përgjigjen në mënyrë të përshtatshme është një detyrë e madhe, për të cilën ia vlen përpjekja. Kjo Paketë Instrumentesh është krijuar për të ndihmuar aktorët lokalë të ndërtojnë qasje pjesëmarrëse në qytetet e tyre përkatëse, duke u mbështetur në përvojën prej disa dekadash të aktorëve humanitarë dhe të zhvillimit lidhur me krijimin e programeve që nxisin përfshirjen dhe integrimin në komunitetet pritëse.

Paketa e instrumenteve është krijuar gjithashtu për të ndihmuar profesionistët të kuptojnë ndikimin e punës së tyre dhe cilat lloje praktikash mund të të cilësohet si praktikë e mirë dhe të përsëriten në kontekste të ndryshme. Nacioni i 'praktikës së mirë' është bërë një koncept kyç për zhvillimin, financimin, zbatimin, vlerësimin dhe promovimin (ndërkombëtar) të këtyre praktikave. Megjithatë, ajo çfarë përbën "praktikë të mirë" në fushën e integritit dhe përfshirjes, në aspekte praktike është kuptuar dobët, dhe nuk shoqërohet me kritere të qarta që mund të përdoren për hartimin dhe zbatimin e një projekti të ri për të rritur në maksimum ndikimin e tij të mundshëm.

---

<sup>1</sup> Për qëllimin e këtij manuali, termi refugjat mund të përfshijë refugjatët, personat të cilëve u është dhënë mbrojtje plotësuese, azilkërkuesit dhe persona të tjerë që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare që i përmbushin kushtet për shërbimet e përshkruara.

Një komunitet i tërë studiuesish dhe një sërë studimesh ndërkombëtare kanë ofruar një pasqyrë të plotë në nivelin makro përsa i përket standardeve të favorshme të integritit dhe politikave kombëtare, të tilla si Mekanizmi Kombëtar i Vlerësimit të Integritit (MKVI), bazuar në pilotimin e UNHCR-së, dhe Indeks të Politikës së Integritit të Migrantëve (IPIM). Megjithatë, në një nivel mikro, profesionistëve të integritit dhe organizmave financues u mungojnë mjetet praktike për të reflektuar mbi drejtimin e duhur të masave dhe për të vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të tyre të mundshme për mbrojtjen specifike dhe nevojat sociale të refugjatëve dhe azilkërkuesve. Kjo paketë instrumentesh kërkon të trajtojë këtë hendek.

Ky dokument ofron një paketë praktike **hap pas hapi dhe materiale komunikimi** për t'u përdorur nga grupet e interesit lokal me qëllim projektimin, monitorimin, nxjerrjen e reagimeve nga përfituesit dhe vlerësimit të praktikave të tyre të integritit dhe përfshirjes.

Paketa e instrumenteve shqyrton gjithashtu kriteret kryesore për të lehtësuar identifikimin e praktikave të mira për integritin dhe përfshirjen. Në secilin kapitull të këtij manuali, praktikat e mira do të paraqiten sipas grupeve specifike të kriterëve dhe faktorëve të suksesit, si dhe potencialit për t'u transferuar tërësisht ose pjesërisht në kontekste të tjera kombëtare dhe vendore ose për të shërbyer si bazë për politikën e integritit.



# 3. STRUKTURA E PAKETËS SË INSTRUMENTEVE

Paketa e Instrumenteve të Integrimit bazohet në kërkimet dhe standardet më të mira të disponueshme nga e gjithë Evropa, duke përfshirë nga qeveritë vendore, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, akademia dhe profesionistët individualë. Paketa e instrumenteve përbëhet nga **Manuali i printueshëm, një version ndëraktiv online i Manualit, një kartë rezultatesh, një video shpjeguese e animuar si dhe një video promovuese që zgjat 1 minut.**

1

## MANUALI I PRINTUESHËM

**Manuali** synon të mbulojë pjesën konceptuale të Paketës së Instrumenteve dhe përfshin materiale të lexueshme dhe multimediale. Ai ofron udhëzime të qarta dhe të sakta për ofruesit e shërbimeve dhe autoritetet vendore që ato të miratojnë një qasje gjithëpërfshirëse për integrimin e refugjatëve dhe është i strukturuar në 6 fusha kyçe. Qëllimi i Manualit është të ndihmojë profesionistët të ofrojnë shërbime të suksesshme duke u dhënë atyre akses në aktivitetet dhe teknikat e praktikave më të mira për përfshirje efektive.

4

## VIDEO SHPJEGUESE E ANIMUAR

**Videoja shpjeguese e animuar** u ofron profesionistëve një mjet shtesë përmes së cilit ata mund të familjarizohen me konceptet kryesore të Manualit. Sidoqoftë, duhet të theksohet se videoja shpjeguese nuk e zëvendëson Manualin, por, përkundrazi, synon të mbështesë temat qendrore të identifikuara në kapitujt.

2

## MANUALI NDËRAKTIV ONLINE

**Versioni ndëraktiv online i Manualit** jo vetëm që u ofron profesionistëve një version më të përshtatshëm të Manualit, por gjithashtu ofron mundësinë për të plotësuar listat e kontrollit vetëvlerësues dhe për të bërë shënime në fund të çdo kapitulli. Këto lista kontrolli dhe shënime më pas përmbledhen automatikisht në fund të Manualit, duke i lejuar profesionistëve të shohin përmbledhjen e tyre të personalizuar.

3

## LISTA E REZULTATEVE

**Lista e rezultateve** është e disponueshme në internet për të ndihmuar profesionistët për identifikimin e praktikave të mira të integrimit përmes përdorimit të një sistemi vlerësimi miqësor për përdoruesit.

5

## VIDEOJA PROMOVUESE


**Videoja promovuese 1 minutëshe** synon të rrisë ndërgjegjësimin për Paketën e Instrumenteve, plus u ofron profesionistëve një ndërgjegjësim konceptual fillestar për qëllimin dhe objektivat e saj.



Paketa e instrumenteve është testuar fillimisht në shtatë shtete pilote (**Bullgari, Itali, Finlandë, Greqi, Maltë, Poloni dhe Serbi**) dhe bazohet në reflektimin dhe reagimet e palëve kryesore të interesit të lidhura me integrimin.<sup>1</sup> This process also intended to create stable networks of practitioners and organisations in each of the countries that fully understand and integrate the Toolkit into their programmes. The aim of this methodology is to ensure that the Toolkit, after an initial ‘

---

<sup>1</sup> Bistra Ivanova (Multi Kulti Collective); Gaia Testore (kërkues dhe konsulent); Sari Vanhanen (Instituti i Migracionit i Finlandës); Jean-Pierre Gauci (Fondacioni Njerëz për Ndryshim); Renata Stefańska (Qendra për Kërkime Migratore, Universiteti i Varshavës; Vladimir Petronijevic (Grupa 484); Konstantinos Vlachopoulos (Fondacioni Helenik për Politikë Evropiane dhe të Huaja - ELIAMEP)



**“Refugjatët duhet, mbi të gjitha, të të dëgohen lidhur me nevojat dhe pritshmëritë e tyre, rreth projektimit të masave për ta dhe në fazën e vlerësimit”**

**PARTNER KOMBËTAR I UNHCR-SË DHE MPG-SË**

# 4. SI TË PËRDORET KJO PAKETË ME INSTRUMENTE?

Për të arritur një qasje gjithëpërfshirëse ndaj integritit dhe përfshirjes, grupet e interesuarit për integrimin e refugjatëve përshtatjes dhe dimensione të caktuara nuk janë të zbatueshme për projektet dhe fushat e tyre të punës, ato kanë mundësinë të përqendrohen te dimensionet kryesore të Paketës së Instrumenteve të cilat janë të rëndësishme dhe vendimtare për ofrimin e shërbimet e tyre për refugjatët.

Për këtë qëllim, **Paketa e Instrumenteve ofron lista kontrolli praktike**, praktika të mira dhe pyetje hap pas hapi rreth hapave që mund të përdoren për të lidhura me të dhënat mbi praktikën e mira Ekzistuese të përfshirjes socio-ekonomike, qasjes efektive ndaj të drejtave dhe kulturore të integritit. Njëkohësisht, Paketa mund shërbejë si një instrument angazhimi dhe shpërndarjeje për komunitetet vendore Për të punuar për integrimin dhe përfshirjen.

Listat e kontrollit:

- **Do të ofrojë udhëzime praktike** për integrimin dhe përfshirjen e refugjatëve në fund të çdo kapitulli;
- **Do t'i mundësojë stafit të njohë nevojat dhe kapacitetet përkatëse** dhe të ndërlidhet më mirë me refugjatët brenda aktiviteteve të tyre;
- **Do të ndihmojë për përshtatjen e shërbimeve me nevojat dhe potencialin e refugjatëve dhe zbatimin** ekzistues dhe të ri të projekteve në përputhje me rrethanat;
- **Do të ndihmojë për vlerësimin nëse praktika janë në 'rrugën e duhur'**;
  - Nëse praktika plotëson të gjitha pikat e listës së kontrollit, kjo do të thotë se organizata ka përqaftuar plotësisht qasjen gjithëpërfshirëse ndaj integritit dhe përfshirjes në fushën kyçe përkatëse;
  - Nëse praktika nuk arrin të përmbushë disa pika të listës së kontrollit, kjo do të thotë se organizata ende duhet të përmirësojë mënyrën se si është projektuar ose ofruar një shërbim për refugjatët;
  - Nëse praktika nuk përmbush asnjë nga pikat e listës së kontrollit, organizata do të duhet të reflektojë thellë mbi shërbimet e saj dhe të përfshijë udhëzimet e Paketës së Instrumenteve për zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve të tij.

**Praktikat e mira** të përfshira në Paketën e Instrumenteve janë identifikuar duke ndjekur kriteret kryesore në secilin kapitull dhe pesë tregues kryesorë të përgjithshëm (shih listën e plotë në faqen 68):

- **Përfshirja dhe pjesëmarrja;**
- **Rëndësia dhe komplimentariteti;**
- **Efektiviteti;**
- **Qëndrueshmëria;**
- **Partneritetet dhe bashkëpunimi.**

**Listat e kontrollit të vetë-vlerësimit** mund të gjenden në manualin online për të mbështetur ofruesit e shërbimeve mbështetëse për vlerësimi dhe monitorimin e praktikave dhe:

- Do t'i ndihmojnë profesionistët të vlerësojnë shërbimet e tyre;
- Do të ndihmojnë për identifikimin e hendeqeve dhe hapësirës për përmirësim të ofrimit të shërbimeve;
- Do t'u japë profesionistëve mundësinë të reflektojnë mbi praktikat ekzistuese dhe të reja dhe të vazhdojnë t'i monitorojnë ato rregullisht;
- Do të mbështesë diskutimin dhe shkëmbimin me aktorë të tjerë për të forcuar strategjitë e integritit dhe përfshirjes.

**Karta e rezultateve** online do t'u ofrojë aktorëve lokalë kritere të qarta për identifikimin e praktikave të mira dhe është një mjet lehtësisht i arritshëm për vlerësimin e shpejtë të praktikave të integritit dhe përfshirjes me anë të një sistemi vlerësimi.

## PËR KË ËSHTË HARTUAR KJO PAKETË INSTRUMENTESH?

Kjo Paketë është hartuar për:

- **Institucionet publike dhe shërbimet në nivelin kombëtar dhe vendor;**
- **Organizatat e shoqërisë civile, përfshirë organizatat e drejtuara nga refugjatët;**
- **Organizatat me besim fetar;**
- **Institucionet arsimore;**
- **Aktorët e biznesit.**

Paketa synon të lidhë dhe diskutojë sfidat e integritit në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të forcojë komunitetet e praktikës. Ajo zbatohet si në nivelin e organizatave dhe profesionistëve që ofrojnë shërbime për refugjatët, të cilët duhet të jenë në gjendje të angazhohen dhe të përqafojnë Paketën për të vlerësuar dhe përmirësuar kulturën dhe strukturën e tyre organizative.


## PËR ÇFARË SHËRBEN KJO PAKETË?

- **Për vetëvlerësim:** grupet e interesit për integritin e refugjatëve mund ta zbatojnë këtë Paketë për të analizuar më mirë praktikat e tyre dhe më pas për të komunikuar dhe reflektuar mbi rezultatet kryesore brenda (brenda ekipit) dhe jashtë (me partnerët dhe palët e tyre të interesit, duke përfshirë edhe vetë refugjatët).

Ata inkurajohen të zbatojnë dhe përdorin këtë Paketë Instrumentesh në të gjitha shërbimet dhe praktikat përkatëse që ata drejtojnë (si ofrues shërbimesh) ose financojnë (si financues/nënkontraktorë). Për ta bërë këtë, një pjesë e Paketës së Instrumenteve është një udhëzues miqësor për përdoruesit, Manuali, i cili shpjegon secilin prej këtyre hapave dhe jep shembuj të përdorimit dhe ndikimit të kësaj qasjeje.

- Për vetëreflektim dhe vetëpërmirësim: kur përdorin këtë Paketë Instrumentesh, grupet vendore të interesit mund t'i shikojnë praktikat e tyre me një 'sy tjetër' për të identifikuar se çfarë funksionon mirë dhe çfarë mund të përmirësohet në procesin e ofrimit të shërbimeve të tyre për refugjatët.

Ata gjithashtu mund të planifikojnë **aktivitete të reja dhe të zhvillojnë projekt propozime** që parashikojnë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj integritit dhe përfshirjes në fushat që janë të rëndësishme për organizatën e tyre. Për ta bërë këtë, brenda Paketës së Instrumenteve, jepen shembuj **të praktikave të mira** që mund të frymëzojnë punën dhe projektet e ardhshme të integritit dhe përfshirjes së refugjatëve, së bashku me **ofrimin e lidhjeve** me burime shtesë për të marrë informacion të mëtejshëm mbi temat dhe praktikat e raportuara.



## 5. CILAT JANË FUSHAT KRYESORE TË NJË QASJEJE GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ INTEGRIMIT DHE PËRFSHIRJES?

Integrimi i refugjatëve është një proces dinamik dhe kompleks i dyanshëm që është specifik për nevojat dhe aftësitë e çdo individi dhe çdo komuniteti lokal<sup>2</sup> Ai kërkon përpjekje si nga shoqëria pritëse, ashtu edhe nga institucionet publike dhe private për të mirëpritur refugjatët dhe për të përmbushur nevojat e tyre dhe kërkon nga vetë refugjatët të përshtaten me mjedisin e ri pa hequr dorë nga identiteti i tyre kulturor. Kur refugjatët ndihen të sigurt, besimplotë dhe të mirëpritur, ata janë në gjendje të investojnë në vendin e tyre të ri të banimit dhe të japin kontribute të vlefshme për shoqërinë. Mbështetja e përshtatshme, motivimi, njohja me kulturën vendore dhe pranimi i mjedisit të ri shoqëror mund të sjellë përfitime të mëdha reciproke.

---


<sup>2</sup> Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, Përfundimet për Integrimin Lokal Nr. 104: <https://www.unhcr.org/excom/exconc/4357a91b2/conclusion-local-integration.html>

Sipas një modeli të suksesshëm dhe gjithëpërfshirës integrimi, gjashtë fusha kyçe janë thelbësore për suksesin e shërbimeve të ofruara për refugjatët:



### 1. QARTËSIA RRETH MBËSHTETJES SË NEVOJSHME PËR REFUGJATËT

Vlerësoni vazhdimisht nevojat, jini të vetëdijshëm për pengesat e lidhura me aksesin dhe përshtatini shërbimet në bazë të komenteve dhe vlerësimeve të rregullta.



### 2. SIGURIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR NEVOJAT E TË GJITHËVE

Harmonizimi i shërbimeve tuaja në mënyrë që grupe të ndryshme të gëzojnë akses të barabartë dhe mbështetje sipas nevojave.



### 3. KRIJIMI I SHËRBIMEVE PËR KUADRIN AFATGJATË

Përdorni perspektivën e përfshirjes afatgjatë përtej fazës së pritjes dhe e integrimit të hershëm.



### 4. PUNA JO VETËM PËR NJERËZIT, POR EDHE BASHKË ME TA

Përfshini refugjatët në planifikim, zbatim dhe vlerësim, vlerësoni komentet e tyre dhe mbajini ata të informuar.



### 5. PËRFSHIRJA E KOMUNITETEVE VENDORE DHE MBËSHTETJA E VULLNETARIZMIT

Mobilizoni burimet e shoqërisë pritëse dhe nxisni besimin dhe identifikimin pozitiv.



### 6. PËRPJEKJE PËR INTEGRIM GJITHPËRFSHIRËS DHE MBËSHTETJE PËRFSHIRËSE

Lidhuni dhe koordinohuni me ofruesit e tjerë dhe plotësoni mangësitë në sistem.



## 5.1. QARTËSIA RRETH MBËSHTETJES SË NEVOJSHME PËR REFUGJATËT

Vlerësoni vazhdimisht nevojat, jini të vetëdijshëm për pengesat ndaj aksesit dhe përshtatini shërbimet rregullisht

Vëmendja ndaj aftësive, kapaciteteve dhe nevojave të refugjatëve është thelbësore për të nxitur në mënyrë efektive integrimin e tyre në shoqëri. Kjo kërkohet që nga fazat më të hershme të konceptimit dhe projektimit të të gjitha operacioneve dhe shërbimeve deri te zbatimi dhe vlerësimi përfundimtar i tyre. Shërbimet e integritit duhet të synojnë t'i forcojnë refugjatët duke i pajisur dhe përgatitur ata për t'iu përgjigjur sfidave me të cilat ata përballen, për të shmangur sjelljet e rrezikshme për të përballuar situatat stresuese dhe për të përfituar nga mundësitë që çojnë në zgjidhje të qëndrueshme.

Ofruesit e shërbimeve dhe autoritetet vendore duhet të përdorin qasën e integruar për projektimin, zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të masave të tyre mbështetëse; dhe të promovojnë aftësinë e refugjatëve për të marrë pjesë me sukses dhe për të përfunduar programet dhe shërbimet. Qëllimi i tyre përfundimtar është fuqizimi i refugjatëve në mënyrë që ata të mund të bëhen pjesë aktive e mjedisit social dhe të kenë akses te burimet ekonomike dhe sociale në mënyrë të pavarur.



### PËRFITIMET E QARTËSISË RRETH MBËSHTETJES SË NEVOJSHME

- Aftësia sociale dhe ekonomike e refugjatëve për të përmbushur në mënyrë të pavarur nevojat e tyre thelbësore në mënyrë të qëndrueshme dhe me dinjitet të rritur;
- Kuptimi më i saktë i nevojave, kapaciteteve, sfidave dhe mundësive të refugjatëve për integrim;
- Shërbime dhe strategji të përshtatura mirë për nevojat specifike të refugjatëve;
- Kapaciteti i refugjatëve për të parandaluar, thithur dhe për t'u rikuperuar nga sfidat e promovuara;
- Ulja çënueshmërisë së refugjatëve dhe e mbështetjes për ndihmë humanitare dhe të jashtme.

## FAKTORËT E SUKSESIT: KRITERET PËR ARRITJEN E PRAKTIKAVE TË MIRA



**Vlerësoni vazhdimisht nevojat:** Të bazuarit e shërbimeve në një vlerësim të rregullt dhe gjithëpërfshirës të nevojave dhe mangësive; rishikimi i rregullt dhe përshtatja e masave në dritën e rrethanave të ndryshuara;



**Vlerësimi i nevojave bazuar në disa burime informacioni:** Vlerësimi i nevojave të refugjatëve në bazë të të gjitha të dhënave përkatëse të disponueshme dhe burimeve të shumta të informacionit;



**Shërbime pa pengesa:** Zhvillimi i shërbimeve pa pengesa gjuhësore dhe kërkesa të rënda administrative;



**Informacion specifik dhe i lehtë për t'u gjetur:** Aktivizimi i aksesit të lehtë në shërbimet tuaja dhe dhënia e informacionit të qartë se si të merret mbështetje;



**Mbështetje sipas nevojave që hap rrugën drejt përfshirjes afatgjatë:** Ofrimi i shërbimeve të synuara të integrit, të cilat çojnë në akses të rregullt në arsim, tregun e punës, strehim, jetën vendore dhe komunitete.





## LISTA E KONTROLLIT LIDHUR ME QARTËSINË PËR MBËSHTETJEN E NEVOJSHME

Lista e mëposhtme e kontrollit jep një proces të detajuar hap pas hapi për të ndihmuar organizatat të planifikojnë dhe identifikojnë të gjitha detyrat e nevojshme për të vendosur për të pasur qartësi në lidhje me mbështetjen e nevojshme për refugjatët.



Për të planifikuar strategjitë dhe shërbimet tuaja të integritit që do të ofrohen, **analizoni të gjithë informacionin përkatës të disponueshëm** mbi situatën e veçantë të refugjatëve, duke përfshirë diskutimet me refugjatët (referojuni fushës kryesore 4 për më shumë detaje); dhe vlerësoni tendencat për rezultatet e integritit për refugjatët;



**Identifikoni nevojat ekzistuese të integritit**, por edhe sfidat e reja të mundshme që lidhen me zbatimin e shërbimeve tuaja. Për shembull, pandemia COVID-19 ka shkaktuar situata të reja problematike si për ofruesit e zakonshëm të shërbimeve ashtu edhe për refugjatët (p.sh. çështjet me mësimin në distancë për trajnimet e integritit për shkak të mungesës së kompetencave të TI-së);



**Përshtatni shërbimet, planet dhe strategjitë** në përgjigje të identifikimit të nevojave dhe sfidave të reja të integritit. Kërkoni kontributin e refugjatëve; dhe nxisni një atmosferë të hapur dhe marrëdhënie të mira për të qenë në gjendje të vlerësoni nevojat e reja dhe shpesh të padukshme të integritit (referojuni fushës kryesore 4.4 për më shumë detaje);



**Hetoni shkaqet e problemeve të integritit** dhe hiqni diskriminimin dhe pengesat për të funksionuar më mirë në të ardhmen. Problemet mund të shkaktohen nga praktikat vendore të komunitetit, anshmëritë institucionale ose pengesat strukturore;



**Shqyrtoni se si të mbështesni kapacitetet e refugjatëve për të trajtuar nevojat e tyre të integritit dhe mundësitë e aksesit për përfshirje socio-ekonomike.** Refugjatët dhe komunitetet e tyre kanë aftësi dhe kapacitete për t'u ndërtuar. Të kuptuarit e mirë të kapaciteteve do t'ju ndihmojë të kuptoni se si të shfrytëzohen dhe përforcohen më së miri këto aftësi dhe kapacitete;



---

**Siguroi mundësitë e paraqitjes së ankesave dhe ofrimit të komenteve** rreth aktiviteteve tuaja duke krijuar mekanizma të pavarur reagimi (p.sh. reagime anonime me shkrim nëpërmjet kutive lehtësisht të aksesueshme në pikat e shpërndarjes, zyrat, qendrat shëndetësore, shkollat, etj.);



---

Jini të vetëdijshëm për **aksesin e shërbimeve** tuaja dhe **pengesat e mundshme** që mund të hasin refugjatët për të pasur akses te to;



---

**Mbuloni diversitetin fetar dhe trajtoni pengesat gjuhësore dhe kulturore** që mund të pengojnë aksesin në shërbimet tuaja; për shembull, ofroni materiale shumëgjuhëshe në formate të ndryshme ose shërbime interpretimi për të mbështetur shërbimet e këshillimit dhe udhëzimit;



---


**Hiqni kërkesat e ngarkuara për dokumentacion** në mënyrë që të keni akses te shërbimet tuaja, të cilat vijnë nga rregullat dhe kushtet që të ardhurit e rinj nuk mund t'i plotësojnë;



---

**Veproni si ndërlidhës dhe ndani informacionin në mënyrë të rregullt**, në mënyrë që refugjatët të mos mbeten vetëm pa njohuri përkatëse të lidhura me shërbimet tuaja.

---



## SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA PËR LEHTËSIMIN E AKSESIT TE SHËRBIMET PËR REFUGJATËT



### MBËSHTETJE SIPAS NEVOJAVE E CILA I HAP RRUGËN PËRFSHIRJES AFATGJATË

Në Finlandë, organizohen takime për 'kalimin në një fazë tjetër' nga shërbimet e posaçme të shërbimit të zakonshme për të sapoardhurit në komunitetet vendore pranuese. Kjo do të thotë që, pas një periudhe të caktuar kohe (3 vjet) kur refugjatët mbështeten me shërbime speciale, bëhet një takim 'kalimi në një fazë tjetër', ku informacioni kryesor mbi situatën e refugjatëve (p.sh. ekzistenca e nevojave specifike etj.) ndahet me autoritetet përkatëse në mënyrë që të jetë nevoja për mbledhjen e tyre përsëri mbi këtë pikë. Qëllimi është të shmanget vazhdimi i 'shërbimeve të posaçme' pas një periudhe fillestare pune intensive ose të specializuar. Ideja e kësaj praktike është që ajo të përgatisë dhe mbështesë refugjatët që të bëhen banorë të zakonshëm të komunitetit, si qytetarët e tjerë finlandezë, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe një komunitet që i përfshin ata, në mënyrë që ata të kenë një jetë normale.

Në Poloni, Qendrat e Ndihmës Familjare në Lublin janë një nga institucionet më të suksesshme të qeverisjes vendore për integrimin e refugjatëve, e cila mbështetet rregullisht në fondet e BE-së. Refugjatët

mund të marrin me qira 3 apartamente në pronësi të qytetit në kuadrin e skemës së strehimit të qytetit, të drejtuar nga Qendra Bashkiake e Mbështetjes së Familjes në Lublin për një periudhë prej 24 muajsh gjithsej. Ky lloj strehimi mund të ndihmojë të huajt në situata veçanërisht të vështira dhe t'i përgatisë ata të ndërtojnë jetën e tyre të pavarur brenda komunitetit lokal.

Në Turqi, Bashkia Metropolitane e Stambollit (BMS) ndjek qasjen e ofrimit të shërbimeve që përfshin përfshirjen e refugjatëve në shërbime të ndryshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në shërbimet sociale, mjetet e jetesës, fuqizimin dhe pjesëmarrjen. Qendra e Fuqizimit të Grave, shtëpitë e lagjeve dhe qendrat e kujdesit ditor Yuvamız Istanbul (Stambolli është shtëpia jonë) ofrojnë shërbime për refugjatët dhe anëtarët e komunitetit pritisë së bashku. Në mënyrë të ngjashme, refugjatët mund të përfitojnë nga qendrat e formimit profesional dhe zyrat e punësimit të BMS. UNHCR-ja më tej mbështet ISMEK-un (Kurset e Artit dhe Trajnimit Profesional të Bashkisë Metropolitane të Stambollit) për digjiitalizimin e kurseve në kontekstin e masave pandemike. Qendra e trajnimit profesional ISMEK synon refugjatët përmes disa moduleve të trajnimit offline në gjuhën arabe, duke përfshirë turqishten për të huajt, teknologjitë e informacionit



dhe kohezionin social. Gjithashtu, si pjesë e Këshillit të Qytetit të Stambollit, një platformë e pjesëmarrjes civile nën BMS, po krijon një grup pune për refugjatët, në mënyrë që ata të japin sugjerimet e tyre dhe të japin komente për BMS-në.

### NEVOJAT E VAZHUESHME PËR AKSES

Në Bullgari, Humans in the Loop (HITL) është një ndërmarrje sociale e vlerësuar me çmime, e themeluar në vitin 2017 me vizionin për të fuqizuar komunitetet e prekura nga konflikti përmes trajnimeve dhe punësimit në industrinë e IT. HITL-ja është shumë aktive në fushën e vlerësimit të nevojave dhe rrethanave të përfituesve. HITL-ja identifikon nevojat dhe sfidat e mundshme përmes procesit të vlerësimit të vazhdueshëm që zhvillohet çdo tremujor të vitit. Për shembull, HITL-ja anketon përfituesit rreth kushteve të punës dhe udhëtimeve personale dhe përvojës gjatë programeve të trajnimit/rritjes së aftësive, si dhe programeve të punësimit. HITL përdor anketa dhe pyetësorë



të thjeshtë që ndihmojnë për analizimin e komenteve dhe zbatimin e ndryshimeve sipas nevojave të reja dhe pengesave të mundshme me të cilat përballen përfituesit në punë ose trajnim. Këto sondazhe përfshijnë gjithashtu një seksion shtesë me reagime, ku përfituesit mund të ankohen çdo sfidë personale me të cilën përballen, pa zbuluar domosdoshmërisht identitetin e tyre. Këto anketa më vonë analizohen dhe raportohen nga departamenti i Ndikimit Social, i cili diskuton të gjitha çështjet që dalin nga përfituesit me personin ose departamentin përgjegjës..

Në Greqi, Agjencia e Zhvillimit të Karditës (ANKA) zbaton programe dhe projekte në zonat rurale dhe urbane të rrethit të Karditës. Për ta bërë këtë, ajo vlerëson reagimet e refugjatëve. Për shembull, ANKA krijoi grupe të fokusuar me përfaqësues të komuniteteve të refugjatëve që jetojnë në qytetin e Karditës. Grupet e fokusuar synojnë të mbledhin komente rreth aktiviteteve, detyrave/projekteve të ANKA-s, të përfshijnë refugjatët dhe komunitetet e migrantëve në procesin e vendimmarrjes dhe të dëgjojnë pikëpamjet e tyre.

Në Poloni, Shoqata "Për Tokën" është një organizatë e vogël bazë e përfshirë në integrimin e refugjatëve në një nga qendrat e refugjatëve në Poloni. Të gjitha veprimet e tyre konsultohen me refugjatët dhe ata gjithashtu shpesh kryejnë aktivitete në përgjigje të kërkesave të refugjatëve, p.sh. takime me një dietolog, mësim si të ngasësh një biçikletë, grumbullimi i parave për të blerë syze ose kompjuterë për fëmijët (të nevojshëm për shkollë gjatë pandemisë Covid-19).



## INFORMACION I LEHTË PËR T'U GJETUR DHE I SYNUAR

Në Bullgari, Shoqata e Zhvillimit e Sofias (Sofia Development Association (SDA)) është një fondacion në nivelin lokal, i cili hapi Zyrën e parë në Sofje për Informacionin dhe Shërbimet për shtetasit e vendeve të treta në shtator të vitit 2021. Ajo është një hapësirë fizike në qendër të Sofjes që synon të ofrojë drejtpërdrejt shërbime informacioni dhe integrimi për migrantët dhe refugjatët që jetojnë në Sofje. Zyra është një nismë e përbashkët midis SDA-së, Bashkisë së Sofjes, UNHCR-së, Kryqit të Kuq Bullgar dhe 13 OJQ-ve që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e integritit të refugjatëve dhe migrantëve. Një nga qëllimet e Zyrës është të ofrojë akses të barabartë dhe të lehtë në shërbimet e ofruara për të gjitha grupet e ndryshme dhe t'i mbështesë ato në nivel lokal. Fletëpalosje të lehta për t'u lexuar në gjuhë të ndryshme, si në anglisht, arabisht, farsi, pashto, etj. ofrohen nga të gjithë partnerët për refugjatët dhe migrantët. Përveç kësaj, planifikohet të vihet në dispozicion një faqe interneti ku do të listohen publikisht shërbimet e ofruara nga Zyra dhe informacioni përkatës do të shpërndahet rregullisht përmes mediave sociale. Zyra drejtohet përmes një projekti të financuar nga BE-ja dhe SDA-ja ka nënshkruar një marrëveshje partneriteti shtesë 4-vjeçare me Bashkinë e Sofjes për të garantuar qëndrueshmërinë e projektit përtej financimit aktual.

Në Poloni, falë Infoline-it të Krizave për Migrantët, migrantët mund të marrin shpejt informacion me telefon ose e-mail se si të aksesojnë shërbimet e ndihmës në Gdańsk. Informacioni është i disponueshëm në disa gjuhë. Linja e ndihmës u hap në përgjigje të një sondazhi mbi ndryshimet që ndodhën në jetën e migrantëve në lidhje me epideminë e Covid-19-ës.



## SHËRBIME PA PENGESA

Në Finlandë, qyteti i Hämeenlinna-S ofron informacion mbi praktikën, politikat dhe shërbimet për migrantët që jetojnë në qytet dhe përreth Finlandës në faqen e internetit [MyIntegration.fi](https://www.myintegration.fi). Përmbajtja e faqes në internet ofrohet në finlandisht, anglisht, arabisht, somalisht dhe rusisht. Përmbajtja është gjithashtu e disponueshme në versionin në audio dhe mund të dëgjohet përmes ReadSpeaker në finlandisht, anglisht, arabisht dhe rusisht. Përmbajtja e faqes së internetit është përgatitur nga vetë migrantët, të cilët mund të parashikojnë më mirë nevojat e grupeve të ndryshme dhe t'u përgjigjen nevojave të tyre. Gjithashtu lexuesit i lejon të japë komente në gjuhë të ndryshme. Nëpërmjet blugut të faqes së internetit, mundësohet edhe leximi i përmbajtjes së prodhuar nga vullnetarë dhe migrantë, të cilët duan të ndajnë përvojat e tyre të integritit me të tjerët. Administratorët e faqes në internet janë në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet dhe shërbimet vendore për të ruajtur përditësimin e përmbajtjes..

## MËSONI MË SHUMË: MATERIALE DHE REFERENCA TË DOBISHME

---

OECD, Working Together for Local Integration of Migrants and Refugees, (2018), OECD Publishing, Paris.

*Ky raport përshkruan se çfarë nevojitet për të formuluar qasjen e bazuar te vendi ndaj integritit nëpërmjet përpjekjeve të bashkërenduara në të gjithë nivelet e qeverisjes, si dhe ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë. Ai paraqet një listë kontrolli prej 12 pikash, një paketë instrumentesh që çdo qytet apo rajon në Evropë, OECD apo më gjerë, mund të përdorë për të punuar në nivele të ndryshme të qeverisjes dhe me aktorë të tjerë lokalë në përpjekjet e tyre për të promovuar integritin më efektiv të migrantëve.*

---

PandPAS, Skemat para dhe pas mbërritjes Për të lehtësuar përfshirjen dhe për të parandaluar ksenofobinë dhe radikalizimin, Welcome! Collection of good practices already existing for refugees' welcoming and first inclusion, 2018

*Ky raport ofron një koleksion të praktikave të mira të integritit të refugjatëve si pjesë e projektit PandPAS mbi 'Skemat para dhe pas mbërritjes për të lehtësuar përfshirjen dhe parandalimin e ksenofobisë dhe radikalizimit'.*

---

Pilat A. & Potkańska D., Local responses to the refugee crisis in Poland. Reception and integration, NIEM analyses, Institute of Public Affairs and Migration Policy Group, Warsaw/Brussels, 2017

*Ky botim identifikon dhe analizon politikat aktuale të integritit ndaj azilkërkuesve dhe refugjatëve në Poloni nga një këndvështrim lokal dhe përshkruan pritshmëritë, politikat, programet dhe aktivitetet e pritjes, paraintegritit dhe integritit, të zbatuara si nga seksioni publik ashtu edhe nga joqeveritar.*

---

UNHCR, Operational guidance on accountability to affected people (AAP), 2020

*Ky raport i UNHCR-së ofron udhëzime se si të zbatohet parimi i llogaridhënies ndaj njerëzve të prekur (AAP), i përshkruar si "një angazhim për përfshirjen e qëllimshme dhe sistematike të nevojave, shqetësimeve, kapaciteteve dhe pikëpamjeve të shprehura të personave me interes për diversitetin e tyre; dhe për të qenë përgjegjës për vendimet tona organizative dhe veprimet e stafit, në të gjitha ndërhyrjet dhe programet e mbrojtjes, ndihmës dhe zgjidhjeve.*

---

UNHCR, The UNHCR Toolkit for Participatory Assessment in Operations, 2006

*Kjo Paketë Instrumentesh e UNCHR-së përshkruan një sërë hapash që duhen ndjekur për kryerjen e*

*një vlerësim pjesëmarrës me refugjatët ose personat e tjerë me interes. Vlerësimi me pjesëmarrje përshkruhet si "procesi i ndërtimit të partneritetit me gratë dhe burrat refugjatë të të gjitha moshave dhe prejardhjeve duke promovuar pjesëmarrje kuptimplotë përmes dialogut të strukturuar".*







## 5.2 SIGURIMI I OFRIMIT TË MBËSHTETJES PËR NEVOJAT E TË GJITHËVE


Integrojini shërbimet tuaja në mënyrë që grupe të ndryshme të kenë akses të barabartë dhe të njëjtin nivel mbështetjeje dhe mbështetje të sipas nevojave

Aksesi i barabartë të mbështetja e ofruar për grupet e ndryshme dhe të cenueshme është thelbësore në të gjitha fazat e ofrimit të shërbimeve. Grupet e cenueshme dhe të ndryshme mund të përfshijnë, për shembull, refugjatët dhe migrantët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat pa shtetësi, fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, viktimat e trafikimit, personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTIQ+, të moshuarit, të pastrehët, gratë në rrezik, personat me probleme mendore dhe fizike, njerëzit që jetojnë në zonat rurale dhe grupet e pakicave. Pabarazitë strukturore dhe diskriminimi (ndërsektorial) i kombinuar me kushte të tjera individuale mund të dëmtojnë në praktikë kapacitetin e tyre për të pasur akses të shërbimeve dhe ndihma bazë.

Kapaciteti për të integruar shërbimet dhe për të trajtuar nevojat specifike të grupeve të ndryshme kërkon burime shtesë dhe ndihmë të synuar. Për këtë qëllim, palët e interesit të lidhura me integrimin dhe përfshirjen do të duhet të japin burime dhe ekspertizë për krijimin e mekanizmave për identifikimin, shqyrtimin dhe referimin e personave me nevoja specifike për të siguruar procese dhe procedura të përshtatshme dhe të aksesueshme.

### PËRFITIMET E SIGURIMIT TË KUJDESTARËVE TË MBËSHTETJES PËR NEVOJAT E TË GJITHËVE

- Integrimi i individëve të cenueshëm në fusha të ndryshme dhe harmonizimi i shërbimeve të integrimit;
- Aksesimi më i mirë i refugjatëve në rrezik më të lartë përjashtimi në tregun e punës, programet e integrimit, vlerësimet e aftësive dhe jetën sociale në komunitetin pritës;
- Shërbime të përshtatura më mirë me nevojat specifike të individëve të cenueshëm;
- Hartimi i strategjisë së reagimit me shumë grupe interesi dhe krijimi i ekipit;
- Kapërcimi i pengesave strukturore, diskriminimit dhe stereotipeve ndaj grupeve të ndryshme të refugjatëve;
- Shmangia e përjashtimit social dhe marginalizimit të refugjatëve;
- Rifitimi i ndjenjës së vetëvlerësimit, besimit dhe fuqizimit të refugjatëve;
- Ndërtimi i rrjeteve midis individëve të cenueshëm dhe me komunitetin pritës dhe institucionet përkatëse (p.sh. organizatat vendore ose kombëtare të aftësisë së kufizuar).



## FAKTORËT E SUKSESIT: KRITERET PËR ARRITJEN E PRAKTIKAVE TË MIRA



**Siguria dhe ndihma:** Trajtoni në mënyrë efektive dhe në kohë cenueshmërinë dhe rrezikun e dëmtimit gjatë gjithë procesit të integritimit;



**Profesionistë multidisiplinarë dhe të kualifikuar:** Sigurohuni që profesionistë multidisiplinorë dhe të kualifikuar të punojnë me grupe të ndryshme vulnerabël të refugjatëve;



**Aksesueshmëria:** Sigurohuni që të gjitha shërbimet dhe objektet tuaja të jenë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse (formatet e qëndrimit, fleksibël dhe pa pengesa komunikimi) dhe që palët e interesit të trajnohen mbi diversitetin;



**Ofrimi bashkëpunues i shërbimeve:** Ofroni shërbime në sinerji me autoritetet vendore, OJQ-të, shërbimet shëndetësore dhe sociale për të mbështetur refugjatët vulnerabël me shërbime të specializuara.







## LISTA E KONTROLLIT LIDHUR ME SIGURIMIN E OFRIMIT TË MBËSHTETJES PËR NEVOJAT E TË GJITHËVE

Lista e mëposhtme e kontrollit jep një proces të detajuar hap pas hapi për të ndihmuar organizatat të planifikojnë dhe identifikojnë të gjitha detyrat e nevojshme për të vendosur për të pasur qartësi në lidhje me ofrimin e mbështetjes për të gjithë.



**Konsultimi me njerëz të grupeve të ndryshme dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së tyre në bashkëprojektimin** e shërbimeve tuaja;



Përpyqje për të **identifikuar, lokalizuar, konsultuar dhe ndjekur** grupet e cenueshme;



Të siguruarit që të gjitha gratë dhe burrat e të gjitha moshave të marrin **informacion të saktë, të lehtë për t'u lexuar dhe të arritshëm** për mënyrën e aksesit në shërbimet tuaja në formate të ndryshme (radio, gojë më gojë, broshurë informacioni në formatin 'lehtësisht e lexueshme', tekste me simbole dhe imazhe, materiale audio-vizuale për fëmijët refugjatë me aftësi të kufizuara intelektuale etj.);



**Arritja e përfaqësimit të balancuar dhe të barabartë** të grupeve të ndryshme për përgatitjen e shërbimeve tuaja;



**Përfshirja e nevojave, shqetësimeve dhe vlerave të ndryshme** të të gjitha grupeve të ndryshme të refugjatëve në hartimin dhe zbatimin e shërbimeve tuaja;



Krijimi i **mekanizmave, hapësirave specifike dhe forumeve të sigurta** për të nxitur aksesin dhe mbështetjen e barabartë të grupeve të ndryshme; për shembull mund të krijohen mjedise joformale për t'u ofruar grave dhe vajzave një hapësirë të sigurt ku të flasin haptazi dhe të marrin këshilla të shëndosha, të flasin lirshëm për përvojat, sfidat dhe madje edhe traumat e tyre pa u gjykuar;



**Projektimi i shërbimeve tuaja për të rritur në maksimum përdorimin e aftësive dhe kapaciteteve të të gjithëve**, duke përfshirë kategoritë më të cenueshme të individëve;



**Trajnimi i partnerëve, njerëzve që punojnë në shërbimet shëndetësore dhe sociale** për t'i dhënë përparësi përfshirjes së grupeve vulnerabël dhe për të **ndërtuar kapacitetin e tyre** për ta zbatuar atë në mënyrë të pavarur.



**Të siguarit që trajnimet dhe seminarët të përfshijnë përfaqësues nga komuniteti lokal dhe rrjete të tilla** si grupet rinore, organizatat e grave, LGBTIQ+, personat me aftësi të kufizuara dhe kolektive të tjera;



**Të siguarit që ofruesit e shërbimeve dhe partnerët e mundshëm të ofrojnë shërbime të specializuara** të jenë të aksesueshme nga grupet vulnerabël; për shembull, përmes ofrimit të akomodimit të përshtatshëm dhe pajisjeve ndihmëse të nevojshme për lëvizjen e refugjatëve me aftësi të kufizuara;



Të siguarit e disponueshmërisë së **shërbimeve fleksibël** gjatë planifikimit dhe realizimit të projekteve, pasi shumë refugjatë punojnë jashtë orarit tradicional të punës dhe ofrimi i mbështetjes së përshtatur dhe joformale për refugjatët (p.sh. miqtë/mentorët, burimet/hapësirat jashtë orarit të shërbimit);



Kur vlerësoni shërbimet tuaja, **bëni pyetje specifike në lidhje me nevojat e grupeve të ndryshme**, përdorni të dhënat e mbledhura për ndërhyrje dhe përshtatini shërbimet tuaja sipas pengesave me të cilat përballen individët e cenueshëm;



Sigurimi që të gjitha grave dhe burrave të të gjitha moshave t'u jepet **mundësia të komentojnë** dhe të japin mendimet dhe komentet e tyre në lidhje me shërbimet e ofruara;



**Rritja e ndërgjegjësimit dhe të folurit për** nevojat specifike të njerëzve që i përkasin grupeve të cenueshme kur diskutoni këto çështje me qeverinë kombëtare dhe vendore, personelin e zbatimit të ligjit, ofruesit e kujdesit shëndetësor, punonjës të tjerë humanitarë dhe median;



**Miratimi i planeve të barazisë**, veçanërisht për shërbimet publike dhe autoritetet vendore, duke përcaktuar mjete konkrete për parandalimin e diskriminimit dhe rritjen e barazisë.

## SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA PËR SIGURIMIN E OFRIMIT TË MBËSHTETJES PËR NEVOJAT E TË GJITHËVE



### AKSESUESHMËRIA

Në Bullgari, [MigrantLife.bg](http://MigrantLife.bg) është një platformë online për ndihmën vetjake që synon fuqizimin dhe mbështetjen e migrantëve dhe refugjatëve që banojnë në Bullgari duke u ofruar atyre informacione të besueshme të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse. Ai përmban kategori të shumta, të tilla si ndihma juridike, punësimi, arsimi, përfitimet sociale, martesë me një shtetas bullgar, shtetësia, trafikimi i qenieve njerëzore, paraburgimi, kthimi vullnetar i asistuar dhe riintegrimi, etj. Aktualisht, ai ofrohet në 7 gjuhë, në bullgarisht, anglisht, arabisht, farsi, urdu, pashto dhe rusisht. Platforma ofrohet në 7 gjuhët më të zakonshme të refugjatëve dhe migrantëve në Bullgari në mënyrë që barrierat gjuhësore të hiqen sa më shumë që të jetë e mundur. Përveç kësaj, ekziston moduli "Kërkoni ndihmë" ku përdoruesit mund të parashirojnë pyetjet e tyre për t'u përgjigjur nga ekipi i FAR-it përmes telefonit, Zoom-it ose emailit. Në këtë mënyrë, refugjatët dhe migrantët që banojnë jashtë Sofjes, ku ndihma juridike e specializuar nga specialistë të fushës dhe ligjit të migracionit nuk është gjithmonë e disponueshme, mund të përfitojnë nga këshilla ligjore profesionale. Artikujt në platformë janë të lehta për t'u lexuar dhe ofrojnë udhëzime hap pas hapi.

Në Finlandë, qyteti i Hämeenlinna-s ofron kurse për migrantët që nuk kanë arsim formal, për shembull, për shkollë të gjendjes shëndetësore,

situatës së jetës ose lejes së lindjes. Qëllimi i këtyre kurseve është të promovojnë aftësitë e gjuhës finlandeze, të përmirësojnë aftësitë e të lexuarit dhe të shkruarit dhe të ofrojnë informacione të interpretuara mbi shoqërinë finlandeze. Pjesëmarrësit gjithashtu mund të ndjekin qëllimet e tyre personale, të tilla si ndërtimi i një rutine të përditshme, takimi me njerëz të tjerë dhe aktivitetet e kohës së lirë. Duke qenë se shumë pjesëmarrës vuajnë nga probleme shëndetësore, gjatë kurseve bëhen disa pushime dhe lloje të ndryshme të aktiviteteve mësimore. Zhvillohen më pak mësimet javore sesa në arsimin formal, në mënyrë që mësimdhënia të mos bëhet shumë e lodhshme dhe dërrmuese për pjesëmarrësit..

Në Suedi, bashkia e [Vänernborg-ut](http://Vänernborg-ut) ka ngritur një njësi të veçantë të pritjes së refugjatëve, e hapur për publikun dy herë në javë, ku refugjatët mund të marrin lehtësisht informacion për ato përfitime për të cilat mund të aplikojnë. Refugjatëve u caktohet një person kontakti për këshilla dhe mbështetje për çështje praktike, për shembull, regjistrimi në një klasë të gjuhës suedeze, regjistrimi i fëmijëve në shkollë, marrja e një llogarie bankare dhe e një karte bankare ose gjetja e mobiljeve të përshtatshme, ose thjesht duke i treguar personit rreth qytetit..

Në Suedi, në [Västra Götaland](http://Västra Götaland), shërbimet sociale kanë rishikuar gjuhën e tyre të shkruar dhe të folur për ta bërë atë më të aksesueshme dhe më pak burokratike. Duke vepruar kështu, ata kanë përmirësuar aftësinë e përfituesve për të kuptuar arsyet mbi të cilat janë dhënë ose rrëzuar vendimet për mbështetje sociale.



## PROFESIONISTËT MULTIDISCIPLINORË DHE TË KUALIFIKUAR

Në Serbi, Refugjatët për Refugjatët (R4R) është një aktivitet pilot i projektit që po zbaton Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut që nga prilli 2021 në partneritet ekzekutiv me Zyrën e UNHCR-së në Serbi. R4R përfshin shkëmbimin e përvojave ndërmjet refugjatëve që kanë jetuar tashmë në vend për një kohë të gjatë dhe refugjatëve dhe azilkërkuesve që kanë nevojë për mbështetje shtesë për t'u integruar në shoqërinë serbe. Asistentët e refugjatëve mund të ndihmojnë njerëzit në një situatë të ngjashme të integrohen dhe të informohen për të drejtat dhe detyrimet e tyre në mënyrën më efektive. Ata mund të fuqizojnë refugjatët e tjerë duke ndarë përvojat e tyre personale dhe një shumëllojshmëri aftësish dhe njohurish që janë thelbësore për të filluar një jetë të re në Serbi.



### PËRDORIMI I GAMËS SË PËRGJITHSHME TË MODELEVE TË MBËSHTETJES

Në Finlandë, Let's Read Together është një rrjet kombëtar që nga viti 2004, i cili ka promovuar shkrim e këndim dhe njohuri në finlandisht midis grave dhe vajzave migrante në Finlandë dhe i inkurajon ato të integrohen në shoqërinë finlandeze. Grupet mësimore mblidhen një herë në javë për dy orë në të njëjtën kohë. Rrjeti po organizon gjithashtu seminare dhe aktivitete dhe boton materiale edukative.



### LIDHJA E MBËSHTETJES ME RRITJEN E NDËRGJEGJËSIMIT

Në Estoni, koncertet e Tolerant Estonia ishin në gjendje të tërhiqnin audiencë të madhe dhe të lidheshin me debatet publike në partneritet me mediat kryesore. Për t'i dhënë një fytyrë njerëzore krizës së refugjatëve dhe për të nxjerrë në pah fatin e individëve, përfshirja e drejtpërdrejtë dhe vizibiliteti i muzikantëve dhe interpretuesve refugjatë ka qenë një element kyç për shumë nga nismat e udhëhequra nga kultura.



## **PËRPUTHJA E SAKTË MIDIS KONTRIBUTEVE TË VULLNETARËVE DHE NEVOJAVE KONKRETE TË REFUGJATËVE**

Në Finlandë, është zhvillua një aplikacion shumë gjuhësor me një sportel si një nismë vendore (p.sh. Choose Your Future, i cili ofron një shërbim të shpejtë të lëvizshëm për migrantët për të zbuluar qytetin ku ata jetojnë, për të gjetur aktivitete interesante, dhe për t'u takuar me njerëzit); startup-i Funzi ofron një aplikacion 'paketë për të mësuar' për azilkërkuesit dhe u jep informacion të besueshëm përdoruesve të telefonave celularë dhe promovon integrimin e tyre në Finlandë.

Në Finlandë, nisma Startup Refugees ka mbështetur qindra migrantë dhe refugjatë për t'u ndjekur ëndrra e tyre për t'u bërë sipërmarrës. Programi drejtohet nga sipërmarrës të njohur dhe përfshin një rrjet prej 300 biznesesh publike dhe OJQ partnere, dhe mbështetet nga 300 vullnetarë. Ai ka hartëzuar aftësitë sipërmarrëse në qendrat e pritjes, ka caktuar mentorë dhe ka filluar inkubatorët e biznesit.



## **FORCIMI I KOMPETENCËS NDËRKULTURORE TË TË GJITHË PERSONAVE TË PËRFSHIRË**

Në Gjermani, Universiteti i Kironit (Kiron University) krijoi një platformë mësimi në internet për refugjatët në mbarë botën dhe komunitetet e pashërbyera në Lindjen e Mesme. 1500 studentë të mundshëm janë regjistruar për studime dyvjeçare në internet në shkencat kompjuterike, inxhinieri, biznes dhe ekonomi dhe shkencat sociale. Studentët ndihmojnë njëri-tjetrin përmes grupeve të studimit online dhe takimeve dhe, nëse kalojnë fazën e parë online, përfitojnë nga hapësirat për të studiuar në 22 universitete partnere.

## MËSONI MË SHUMË: MATERIALE DHE REFERENCA TË DOBISHME

---

Broshura e EESC-së, [How Civil Society Organisations Assist Refugees and Migrants in the EU: Successful experiences and promising practices from the 2016 EESC Civil Society Prize](#), 2017

Ky botim jep një pasqyrë të përgjithshme të nismave të shoqërisë civile për integrimin e suksesshëm të refugjatëve dhe migrantëve në BE.

---

Ekipi editorial i EWSI-t, [Comparative analysis: Voluntary and citizens' initiatives before and after 2015](#), European web site on integration, 2016

European Web Site on Integration ofron një analizë, duke përfshirë një përmbledhje të përgjithshme të nismave vullnetare që janë shfaqur në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Nismat e reja hartohen, krahasohen me ato pak më të vjetra, dhe

analizohen për novacionin që sjellin, vlerën e shtuar dhe ndikimin e mundshëm mbi integrimin.

---

Rrjeti Sirius, [Mentoring: What can support projects achieve that schools cannot?](#) 2014

Kjo përmbledhje eksploron përfitimet e mentorimit dhe profesionalizimit të organizatave mentoruese, dhe se si politikëbërësit mund të hartojnë mentorim dhe projekte të tjera mbështetëse arsimore për të qenë pjesë integrale e peizazhi arsimor. Ajo gjithashtu thekson shembuj të përvojave të suksesshme të mentorimit, të cilat përqendrohen te kultivimi i talenteve dhe potencialit të fshehur të fëmijëve të migrantëve.

---

UNHCR, [A Community-based Approach in UNHCR Operations](#), 2008

Ky manual i UNHCR-së synon të mbështesë stafin për zbatimin e një qasjeje të bazuar në

komunitet në veprimtaritë e tyre për të siguruar që njerëzit me interes për fushën të vendosen në qendër të të gjitha vendimeve që kanë ndikim mbi jetën e tyre.

---

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) dhe organizata Terre des hommes (Tdh), [Sport for Protection Toolkit Programming with Young People in Forced Displacement Setting](#), 2018

Kjo paketë e instrumenteve "Sport për Mbrojtje" shërben si udhëzues i punës së Fondacionit Olimpik të Refugjatëve dhe mund të përdoret nga një grup i gjerë organizatash dhe grupesh interesi për të kuptuar dhe zbatuar më mirë programin efektiv "Sport për mbrojtje".

---

Wolffhardt, A., Conte, C. & Huddleston, T., [The European Benchmark for Refugee Integration: A Comparative](#)

[Analysis of the National Integration Evaluation Mechanism In 14 EU Countries](#), Warsaw/Brussels, 2019

Ky raport i NIEM-it paraqet një vlerësim krahasues të bazuar në tregues të kornizave të integrimit të refugjatëve në 14 vende të BE-së. Analiza përqendrohet te treguesit ligjorë, treguesit e politikave dhe treguesit që masin integrimin, koordinimin e politikave, si dhe përpjekjet që synojnë pjesëmarrjen dhe përfshirjen e shoqërive pranuese.







## 5.6 PËRPPJEKJE PËR INTEGRIM GJITHPËRFSHIRËS DHE MBËSHTETJE PËR PËRFSHIRJE

Lidhuni dhe koordinohuni me ofruesit e tjerë dhe mbushni mangësitë në sistem.

Qasja gjithëpërfshirëse për integrimin e refugjatëve kërkon një përgjigje mbarëqeveritare dhe të gjithë shoqërisë. Ajo përfshin bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të bazuar në partneritet ndërmjet të gjithë aktorëve përkatës, duke përfshirë autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, shërbimet publike, partnerët socialë dhe shoqërinë civile. Qasja gjithashtu nënkupton financim strukturor dhe afatgjatë për integrimin si dhe akses në financim të qëndrueshëm për nivelin lokal dhe organizatat e shoqërisë civile. Bashkëpunimi dhe ofrimi i politikave të përbashkëta premtojnë për politika më të përqendruara, duke iu përgjigjur më qartë nevojave dhe perspektivave të refugjatëve.

Me legjitimitet më të madh që rrjedh nga një pjesëmarrje më e gjerë dhe më shumë shoqëri civile dhe aktorë lokalë/rajonalë që marrin përsipër një rol, politikat mund të bëhen gjithashtu më të qëndrueshme dhe të arrijnë një ndikim më të fortë. Përmes mbështetjes aktive nga autoritetet publike për ndihmën që ato ofrojnë, OJQ-ve u mundësohet të kontribuojnë për përfshirjen afatgjatë të refugjatëve në shoqërinë pritëse.

### PËRFITIMET E PUNËS ME REFUGJATËT

- Partneritete të qëndrueshme dhe afatgjata me shumë palë në nivele të ndryshme të qeverisjes, të cilat fuqizojnë aktorët për të kontribuar në procesin e integrimit të refugjatëve;
- Integrimi dhe menaxhimi i diversitetit, i integruar në të gjitha fushat, shërbimet dhe fushat e politikave përkatëse;
- Forcimi i koordinimit ndërmjet autoriteteve rajonale dhe vendore për integrimin e refugjatëve;
- Koordinim më i mirë ndërmjet autoriteteve vendore dhe organeve/ bordeve/ofruesve të shërbimeve të punësimit, shëndetësisë, strehimit dhe arsimit;
- Sigurimi i vazhdueshëm i burimeve dhe mbështetja për autoritetet vendore, OJQ-të dhe organizatat mbështetëse jofitimprurëse nxisin përfshirjen afatgjatë të refugjatëve.





## FAKTORËT E SUKSESIT: KRITERET PËR ARRITJEN E PRAKTIKAVE TË MIRA



### **Strategji me disa nivele për palët kryesore të interesit:**

Zhvillimi së bashku i një strategjie gjithëpërfshirëse integrimi duke përfshirë autoritetet rajonale dhe vendore, ofruesit e shërbimeve dhe shoqërinë civile;



**Pronësia dhe Pjesëmarrja:** Mbështetje për përfshirjen dhe konsultimin e rregullt të refugjatëve në aktivitetet qytetare, jetën sociale të komunitetit lokal dhe vendimmarrjen;



**Përfshirja e shoqërive pritëse:** Njohja e integritit si një proces i dykrahshëm dhe mbështetja e një roli aktiv të shoqërisë pritëse për të zbatuar më mirë politikatat publike vendore;



**Disponueshmëria e fondeve strukturore:** Sigurimi i mjeteve të qëndrueshme, të larmishme dhe të mjaftueshme për masat integruese, duke lejuar vazhdimësinë dhe rritjen. Në shumë vende dhe kontekste, kjo nënkupton akses në fondet e BE-së për autoritetet vendore, shoqërinë civile dhe organizatat e udhëhequra nga refugjatët.





## LISTA E KONTROLLIT PËR T'U LIDHUR DHE KOORDINUAR ME OFRUESIT E TJERË DHE PËR PLOTËSIMIN E MANGËSIVE NË SISTEM

Lista e mëposhtme e kontrollit jep një proces të detajuar hap pas hapi për të ndihmuar organizatat të planifikojnë dhe identifikojnë të gjitha detyrat e nevojshme për t'u lidhur dhe koordinuar me ofruesit e tjerë të shërbimeve



**Krijimi i strategjive** që presin ose detyrojnë shoqërinë pritëse të përfshihet në mënyrë aktive dhe të akomodojë përfituesit;



**Krijimi i strategjive** që përfshijnë autoritetet rajonale, vendore dhe ofruesit e shërbimeve për të nxitur integrimin e refugjatëve dhe për të siguruar mjete për zbatimin e këtyre strategjive;



**Ngritja e një mekanizmi me shumë palë** për të zhvilluar së bashku strategji gjithëpërfshirëse për integrimin dhe përfshirjen dhe rishikimin e veprimtarive, praktikave, shërbimeve dhe rezultateve të integrimin në koordinim me partnerët përkatës (autoritetet vendore, OJQ-të, partnerët social, kërkimin shkencor, institucionet, etj.



**Ndërtimi i partneriteve rajonale** për të siguruar përfshirjen dhe integrimin e refugjatëve dhe migrantëve në zonat rurale të cilët mund të jenë në një situatë më të cenueshme për shkak të largësisë, izolimit dhe aksesit të kufizuar në shërbimet e synuara;



**Inkurajimi i nismave vullnetare** për të plotësuar politikat publike duke financuar koordinimin e nismave të tilla në të gjitha nivelet, duke i bërë ato pjesë të ofertave standarde të integrimin për refugjatët (më shumë informacion shih: 5.5 Përfshirja e komuniteteve vendore dhe mbështetja e vullnetarizmit);



**Mbështetja e përfshirjes së refugjatëve** në aktivitete qytetare nëpërmjet informacionit të synuar mbi të drejtat dhe mundësitë e refugjatëve për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të tilla, si dhe duke ofruar mjete për organizatat për të kontaktuar refugjatët;



**Krijimi i një organi për t'u konsultuar me refugjatët** për çështje që kanë të bëjnë me integrimin dhe përfshirjen e tyre, duke përfshirë shoqatat e refugjatëve ose përfaqësuesin e zgjedhur si anëtarë të përhershëm dhe sigurimi i mjeteve për krijimin e organeve të përhershme konsultative;



**Menaxhimi dhe financimi i rregullt i fushatave** për të sensibilizuar shoqërinë pritëse për situatën e refugjatëve, për të luftuar diskriminimin dhe për të luftuar paragjykimet dhe perceptimet e gabuara;



**Ofrimi**, si autoritet publik që menaxhon ose shpërndaj fondet e BE-së, **i aksesit në fondet e BE-së** për organizatat e shoqërisë civile dhe autoritetet vendore. Informimi i aktorëve për mundësitë e financimit dhe përfshirja e tyre si partnerë në procesin e programimit kombëtar të fondeve përkatëse;



**Përdorimi strategjik i financimit të BE-së ose financimeve të tjera** ndërkombëtare për të mbushur mangësitë në sistemin e mbështetjes, pilotimi dhe testimi i nismave të reja dhe mësimi nga modelet dhe përvojat ekzistuese. Shfrytëzimi i plotë i të gjitha instrumenteve të disponueshme, duke përfshirë ndër të tjera Fondin Social Evropian ([ESF](#)) dhe Fondin e Migracionit dhe Integritimit për Azilin ([AMIF](#)).



## SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA PËR NJË QASJE GJITHPËRFSHIRËSE



### STRATEGJI ME DISA NIVELE PËR PALËT KRYESORE TË INTERESIT

Në Serbi, Planet Vendore të Veprimit (PLV) synojnë të përmirësojnë standardet e jetesës dhe standardet socio-ekonomike të kategorive të synuara të të zhvendosurve me forcë dhe migrantëve. Planet synojnë të zgjidhin problemet e këtyre kategorive në mënyrë të planifikuar dhe afatgjatë, duke krijuar masa dhe veprime plotësisht të përshtatura me nevojat e tyre reale. Kjo mundëson përdorimin më me kosto efektive të burimeve ekzistuese (materiale, teknike, njerëzore dhe institucionale) përmes rrjetëzimit të institucioneve përkatëse vendore dhe partnerëve të tjerë vendorë. PLV-ja paraqet të dhënat e disponueshme për moshën, gjininë dhe nevojat arsimore për secilën nga kategoritë e ndryshme të migrantëve të zhvendosur me forcë dhe identifikon grupet prioritare ose nëngrupet më të cenueshme. Pushteti vendor regjistron me saktësi problemet dhe nevojat e kësaj popullate dhe planifikon ose propozon zgjidhje në përputhje me rrethanat. Për secilën nga kategoritë e ndryshme të identifikuar të migrantëve të zhvendosur me forcë, përcaktohen objektiva specifike. Për shembull, në PLV-në e një bashkie ([the LAP of the municipality of Bačka Topola](#)), në periudhën

2020-2024, një objektivi është krijimi i kushteve për forcimin e tolerancës dhe mirëkuptimit të nevojave të azilkërkuesve dhe migrantëve në nevojë duke përmirësuar cilësinë e jetës në komunitetin lokal, pajisjen me hapësira për shërbime shëndetësore, arsimore, kulturore dhe të tjera, kënde lojërash për fëmijë dhe sport. Planet vendore përgatiten në bashkëpunim me institucionet përkatëse në secilën bashki dhe zbatohen në partneritet me aktorë të ndryshëm.

Në Poloni, [Këshilli për Modelin e Integritimit të Migrantëve \(Council for the Model of Migrants' Integration\)](#) në provincën e Mazowieckie-s mbledh së bashku entitete të ndryshme të përfshira në integrimin e të huajve: Zyra e Voivodeshipit Mazovian, Bordi i Arsimit, Qendra e Ndihmës Sociale, Zyra e Punës e Varshavës, Caritas Poloni, Fondacioni Polak i Forumit të Migracionit, Fondacioni për Somalinë, Fondacioni i Mësimin të Gjuhëve të Huaja Linguae Mundi, Shoqata për Ndërhyrje Ligjore dhe Fondacioni për Dialog dhe Tolerancë. Objektivi i Këshillit ishte që të diagnostikonte situatën dhe nevojat e të huajve në

fusha të ndryshme të integritimit dhe të hartonte rekomandime. Përfundimet nga konsultimet brenda Këshillit u përdorën në botimin "Të huajt në Poloni, manual për njerëzit që punojnë me migrantët." Për më tepër, është hartuar një dokument i titulluar "Supozimet për strategjinë për integrimin e migrantëve në Voivodeshipin Mazowieckie". Këto dokumente do të mbështesin aktivitetet e integritimit në provincën Mazowieckie dhe do të përdoren për krijimin e një strategjie mbarëkombëtare për integrimin e emigrantëve.

Në Suedi, [Skane Partnership](#), i kushton një theks shumë të fortë punës afatgjatë për pjesëmarrjen dhe njohjen e migrantëve të sapoardhur. Ky partneritet është një praktikë rajonale (në nivel kaunti) që përfshin një numër të konsiderueshëm komunash. Në Partnership Skåne, organizatat që janë përgjegjëse për pritjen dhe vendosjen e të ardhurve në Skåne, janë bashkuar për të zhvilluar së bashku metoda dhe për të siguruar kushte për trajtimin e nevojave prioritare ku është i nevojshëm bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i burimeve.



Në Bullgari, rrethi Oboriste i Komunës së Sofjes është një nga autoritetet e para dhe të vetme vendore të Bullgarisë që zbaton politikën kombëtare për integrimin e refugjatëve. Duke vepruar kështu, Oboriste mirëpret një numër të madh familjesh refugjatësh që dëshirojnë të vendosen në Sofje dhe u ofron atyre mbështetje fillestare integruese sipas kompetencave të distriktit deri në 6 muaj. Këto shërbime përfshijnë strehimin, mbështetjen me regjistrimin në shkollat publike vendore si dhe mbështetjen sociale komunale aty ku është e zbatueshme. Përpjekja e Oboristes për integrimin e refugjatëve filloi në vitin 2020 me rivendosjen e 2 familjeve të mëdha që kërkonin azil në Bullgari (15 anëtarë gjithsej). Në vitin 2021 Oboriste priti 5 familje (gjithsej 27 anëtarë) në kuadër të një projekti të financuar nga AMIF-ja, i quajtur “Së bashku për Integrim”. Projekti bazohet në një qasje shumëpalëshe dhe udhëhiqet nga Kryqi i Kuq Bullgar dhe dy partnerë të tjerë: distrikti Vitosha i Bashkisë së Sofjes dhe Qendra e Fondacionit Nadya. Kryqi i Kuq Bullgar merr pjesë me punonjës socialë dhe përkthyes dhe Qendra Nadya me psikologë. Ky projekt do të zgjasë deri në dhjetor 2022 dhe për të

siguruar qëndrueshmëri, ekipi tashmë ka aplikuar për 2 projekte të reja me financim evropian dhe ndërkombëtar.

Në Finlandë, Kryqi i Kuq Finlandez koordinon dhe zhvillon Rrjetin për Shoqatat Joqeveritare. Rrjeti mbledhet 4 herë në vit dhe diskuton tema përkatëse brenda temave të pritjes dhe integritit. Ka edhe disa ministri të pranishme në takimet e rrjetit, kështu që mbështetet rrjedha e informacionit nga sektori i tretë të autoritetet dhe anasjelltas. Një nga mjetet për krijimin e të cilit ka ndihmuar rrjeti është një platformë integrimi për organizatat (kotoutumistarjotin). Kjo Paketë me Instrumente ndihmon për të kuptuar se çfarë lloji aktivitete ofrojnë aktorët e sektorit të tretë në zonën vendore, gjë që ndihmon të ardhurit në procesin e integritit. Platforma ndihmon për të kuptuar ndarjen e aktiviteteve ndërmjet aktorëve të sektorit të tretë dhe autoriteteve p.sh. në nivel bashkie.

Në Lituani, Plani i Veprimit 2018-2020 për integrimin e të huajve në shoqërinë lituaneze (the 2018-2020 Action Plan on the Integration

of Foreigners into Lithuanian Society) kërkon bashkëpunim dhe koordinim të rregullt ndërmjet OJQ-ve, Shoqatës së Autoriteteve Vendore, arsimit, shërbimeve të kujdesit social dhe shëndetësor për të siguruar integrimin e suksesshëm të refugjatëve në shoqëri.

Plani i Veprimit u kërkon autoriteteve dhe organeve arsimore në nivel rajonal dhe vendor që të ofrojnë trajnime për punonjësit e arsimit për të përmirësuar aftësitë ndërkulturore, për të ulur stereotipet dhe për të promovuar vlerat e respektimit të diversitetit dhe barazisë. Janë parashikuar gjithashtu aktivitete arsimore për punëdhënësit për t'i informuar ata për nevojat e integritit dhe diversitetit të refugjatëve për sa i përket gjinisë, moshës, vendit të origjinës dhe statusit familjar. Plani synon të monitorojë proceset dhe politikat integruese duke mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore dhe regjistrimin e tyre pranë autoriteteve shtetërore.





## PËRFSHIRJA E SHOQËRIVE PRITËSE

Në Itali, projekti “Diffondere diversita’ rafforzare comunita’” synon krijimin e mundësive të punësimit për refugjatët dhe azilkërkuesit në sektorin e bujqësisë dhe mbështetjen e zhvillimit lokal në një zonë rurale. Projekti përfshin dy njësi vendore (Komunën Losine dhe Komunën Cerveno) dhe Bio Distretto e Valcamonica, një rrjet i bujqësisë organike i përbërë nga 40 ndërmarrje të vogla. Projekti promovon një formë të thjeshtë por efektive të ndarjes së punës ku dy ose më shumë ndërmarrje bashkojnë burimet dhe fuqinë punëtore të tyre. Në praktikë, punëtorët e bujqësisë punësohen në kushte të rregullta nga një grup punëdhënësish që ndajnë shërbimet e punëtorëve gjatë gjithë vitit. Kjo marrëveshje ul kostot e punës, krijon mundësi të reja pune dhe mbështet promovimin e punësimit në bujqësi në kushte të drejta pune. Për më tepër, ndërmarrjet bujqësore bëhen pjesë e një rrjeti, i cili mund t’u japë përparësi ndërmarrjeve pjesëmarrëse. Ai gjithashtu parashikon një rol aktiv të shoqërisë pritëse për zbatimin e tij duke përfshirë drejtpërdrejt një shoqatë vullnetare të ndërmarrjeve të vogla bujqësore që bashkëpunojnë për të mbështetur njëra-tjetrën dhe fermerët e rinj dhe familjet e tyre që mbështesin aktivisht migrantët në procesin e integrit.

Në Itali, Rajoni Emilia-Romagna promovon në mënyrë sistematike mësimin e gjuhëve të huaja dhe ndërmjetësimin ndërkulturor (second language learning and intercultural mediation) për përfshirjen e migrantëve dhe refugjatëve në shoqëri dhe përgjigjen ndaj rritjes eksponenciale të flukseve gjatë viteve të fundit. Për ta bërë këtë, Rajoni punon së bashku me shkollat publike, sektorin jofitimprurës, komunat, organet e tjera publike dhe komunitetet vendore. Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe kooperativën ndërtohet nëpërmjet një partneriteti shumë-nivelësh dhe të strukturuar.

Në Belgjikë, kryeqyteti i Brukselit miratoi Planin e Veprimit kundër Racizmit dhe Diskriminimit (Action Plan Against Racism and Discrimination) 2018-2020 për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të angazhuar çdo ministër dhe sekretar shteti në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit. Plani bazohet te 23 masa konkrete politike për krijimin e një shoqërie ku toleranca dhe solidariteti mes popullsisë zënë një vend qendror. Është krijuar një platformë konsultative për të bashkëpunuar me çdo organizatë të shoqërisë civile të Brukselit që dëshiron të bashkëpunojë dhe të punojë sipas këtij plani.

Në Finlandë, projekti ‘Föreningsliv för alla’ synon të mbështesë pjesëmarrjen sociale të migrantëve duke nxitur përfshirjen e tyre në shoqatat finlandeze. Ky projekt u jep migrantëve mundësinë të trajnohen në një gjuhë të re jashtë mjedisit shkollor, të ndërtojnë rrjetet e tyre informale dhe kontakte të reja kuptimplote. Si rezultat i projektit, rajoni Jakobstad përdor modelin “e dykahshëm” të integritit përmes përfshirjes së sektorit të tretë dhe të shoqatave.

Në Turqi, Bashkia Metropolitane e Gaziantepit, Departamenti i Grave, Familjes, Arsimit dhe Shërbimeve Sociale themeloi Qendrën Komunitare Ensar në vitin 2014. Qendra është konceptuar si një hapësirë e sigurt për anëtarët e të dyja palëve, komuniteteve pritëse turke dhe refugjatëve, që ata të vijnë dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe të mësojnë aftësi të reja. IOM filloi të mbështesë Qendrën Komunitare Ensar në vitin 2017 duke e rinovuar dhe rehabilituar atë dhe duke kryer aktivitete të përfshirjes sociale si dhe aktivitete jashtëshkollore. Qendra është e hapur për të gjitha moshat, gjinitë dhe kombësitë. Aktivitetet dhe shërbimet e ofruara kanë një ndikim pozitiv në komunitet duke përmirësuar komunikimin midis refugjatëve dhe komunitetit pritës dhe nxisin lidhje dhe ndërveprim më të mirë përmes aktiviteteve sociale.



## PRONËSIA DHE PJESËMARRJA

Në Suedi, një praktikë e mirë e sipërmarrjes sociale përfaqësohet nga Yalla Trappan, një ndërmarrje sociale për integrimin e punës dhe kooperativë e grave, e drejtuar nga një shoqatë jofitimprurëse në Malmö. Ajo ofron trajnime pune në tre fusha: kafene dhe shërbime katering, studio qepëse, shërbime pastrimi dhe konferencash. Yalla Trappan përdor modelin e 'të mësuarit duke bërë' për të promovuar pavarësinë financiare për gratë migrante që janë në rrezik të lartë të përjashtimit nga tregu i punës.

Në Finlandë, Këshilli Finlandez i Refugjatëve organizon një kurs 'Orientimi Qytetar' që synon migrantët e rritur së fundmi në Finlandë. Kursi ofron informacion të plotë mbi qëndrimin, jetesën dhe punën në Finlandë. Ai ofron aftësi qytetare të nevojshme në vend dhe i familjarizon migrantët me historinë e kombit finlandez. Objektivi i këtij kursi është të përmirësojë kuptimin e refugjatëve dhe të ardhurve për shoqërinë finlandeze dhe të qartësojë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në vend. Çdo kurs ofrohet nga një trajner që flet të njëjtën gjuhë si pjesëmarrësit e kursit. Konceptet, metodat e mësimdhënies dhe tekstat e kursit janë të disponueshme për përdorim të pakufizuar në bashki dhe

institucione mësimore. Në fazën e zhvillimit të këtij projekti, janë përfshirë palët kryesore të interesit, duke përfshirë bashkitë e rajonit të Helsinkit dhe Ministrinë e Punës dhe Ekonomisë.

Në Turqi, Bashkia Yıldırım ka ofruar mbështetje për refugjatët në aspektin e mbrojtjes, jetesës dhe kohezionit social që nga fillimi i situatës së refugjatëve sirianë në Turqi. Bashkia krijoi një Qendër të Kohezionit Social në zonë, e cila është një nga nismat e para për të synuar përfshirjen e refugjatëve për ofrimin e shërbimeve nga një bashki në Turqi. Qendra bashkon refugjatët dhe anëtarët e komunitetit pritës nëpërmjet aktiviteteve të strukturuar, të tilla si terapia e lojërave, për të lehtësuar lidhjen me njëri-tjetrin dhe tejkalimin e problemeve, si dhe forcimin e aftësive për zgjidhjen e problemeve. Gjithashtu, ata organizojnë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe shpërndarjen e informacionit për aksesin në shërbime. Përveç kësaj, qendra ofron mbështetje për kooperativat e grave, duke përfshirë anëtarët refugjatë, me synimin për t'u ofruar grave mundësi fuqizimi dhe mbështetjeje të vetja.

## MËSONI MË SHUMË: MATERIALE DHE REFERENCA TË DOBISHME

Asambleja e Rajoneve Evropiane (AER), Tuning of AMiD Outcomes to European Local Authorities, Access to Services for Migrants with Disabilities (AMID), 2019

Ky raport ofron njohuri se si të mbështetet një menaxhim efikas i pritjes dhe integritimit të refugjatëve, azilkërkuesve dhe migrantëve me aftësi të kufizuara në BE.

Komisioni Evropian, Toolkit on the use of EU funds for the integration of people with a migrant background, 2018

Kjo Paketë synon të ndihmojë autoritetet kombëtare dhe rajonale të financimit për zbatimin e politikave të integritimit që synojnë njerëzit me prejardhje migrante përmes përdorimit të fondeve të BE-së në periudhën e programimit 2014-2020.

Huddleston, T., Bilgili, O., Joki, A. & Vankova, Z., MIPEX Migrant Integration Policy Index, Barcelonë/Bruksel, 2015

Indeksi i Politikës së Integritimit të Migrantëve (MIPEX) është një projekt unik afatgjatë i cili vlerëson dhe krahason se çfarë po bëjnë qeveritë për të promovuar integritimin e migrantëve në të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe në disa shtete jo anëtare të BE-së.

Ekipi Editorial i EWSI-t, What measures are in place to ensure the long-term integration of migrants and refugees in Europe? European Web Site on Integration, 2020

Ekipi Editorial i EWSI-t bën kërkime për një sërë treguesish të integritimit afatgjatë në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së dhe Mbretërinë e Bashkuar dhe analizon praninë ose disponueshmërinë e politikave ose masave specifike për refugjatët.

Natale, F., Kalantaryan, S., Scipioni, M., Alessandrini, A. and Pasa, A., Migration in EU Rural Areas, Science for Policy

report by the Joint Research Centre (JRC), Luxembourg, 2019

Ky raport ofron një pasqyrë sasiore të migrimit në zonat rurale për të gjithë BE-në dhe kontribuon për rritjen e ndërgjegjësimit për fenomenin pak të studiuar të migrimit në zonat rurale.

Wolffhardt A., Operationalising a comprehensive approach to migrant integration, RESOMA Discussion Policy Brief, 2019

Kjo përmbledhje e politikave ReSOMA shpjegon nocionin e qasjes gjithëpërfshirëse ndaj integritimit dhe shtjellon potencialet specifike, por edhe kufizimet, e nivelit lokal për integritimin e migrantëve. Ajo paraqet dhjetë pika fokale të mundshme, konkrete dhe të financueshme për zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë në praktikë.

Wolffhardt, A., Conte, C. & Huddleston, T., The European Benchmark for Refugee Integration: A Comparative Analysis of the

National Integration Evaluation Mechanism In 14 EU Countries, Warsaw/Brussels, 2019

Ky raport i NIEM-it paraqet një vlerësim krahasues të bazuar në tregues të kornizave të integritimit të refugjatëve në 14 vende të BE-së. Analiza përqendrohet te indikatorët ligjorë, treguesit e politikave dhe treguesit që matin integritimin, koordinimin e politikave, si dhe përpjekjet e synuara në pjesëmarrjen dhe përfshirjen e shoqërisë pritëse.

Wolffhardt, A., Conte, C. & Huddleston, T., The European Benchmark for Refugee Integration: A comparative analysis of the national integration evaluation mechanism in 14 EU countries, Evaluation 1: Comprehensive Report, 2020

Ky raport i NIEM-përmban të dhënat dhe zhvillimet kryesore mbi integritimin e refugjatëve në periudhën 2017-2019, pasi ato pasqyrohen në rezultatin e shënuar të kërkimit të kryer në 14 vendet pjesëmarrëse.

## 6. LISTË GJITHPËRFSHIRËSE KONTROLLI PËR ZHVILLIMIN E NJË NISME GJITHPËRFSHIRËSE INTEGRIMI DHE PËRFSHIRJEJE:

- Identifikimi i nevojave dhe potencialit të refugjatëve në mënyrë të rregullt;
- Trajtimi dhe heqja e pengesave gjuhësore dhe administrative për të pasur akses në shërbimet tuaja;
- Përshtatja e planeve dhe strategjive tuaja sipas nevojave, kapaciteteve dhe reagimeve të refugjatëve;
- Ofrimi i shërbimeve për nxitjen e përfshirjes social-ekonomike të refugjatëve përtej fazës fillestare të pritjes;
- Diversifikimi i mundësive të financimit për integrim afatgjatë;
- Përfshirja e refugjatëve në vlerësimet, planifikimin, zbatimin, monitorimin, përshtatjen dhe vlerësimin e shërbimeve tuaja; Sigurimi që grupet e cënueshme të përfshihen në bashkëprojektimin e shërbimeve tuaja;
- Sigurimi që individët e cënueshëm të gëzojnë akses të barabartë dhe të njëjtin nivel mbështetjeje si refugjatët e tjerë;
- Pyetja e refugjatëve për reagimet e tyre pasi të jenë ofruar shërbimet dhe informimi i rregullt i tyre;
- Promovimi i aktiviteteve vullnetare dhe që përfshijnë komunitetin lokal për të inkurajuar integrimin social, ekonomik dhe kulturor të refugjatëve;
- Mbështetja e nismave vendore për refugjatët, të tilla si koha e lirë, arsimi, punësimi, familja dhe këshillimi 'burokratik';
- Krijimi i një bashkëpunimi të vërtetë të bazuar në partneritet dhe përfshirja e të gjithë aktorët përkatës të integrit, duke përfshirë autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, shërbimet publike, partnerët socialë dhe shoqërinë civile;
- Rishikoni operacionet tuaja, praktikat, shërbimet dhe rezultatet e integrit në koordinim me partnerët përkatës.

# 7. TREGUESIT PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË PRAKTIKAVE TË INTEGRIMIT

Shumica e praktikave të mira në Paketën e Instrumenteve janë përzgjedhur si ekzemplare dhe pas vlerësimit të tyre sipas listës së mëposhtme të kriterëve dhe treguesve:

## 1. DIMENSIONI: PËRFSHIRJA DHE PARTNERITETI

Treguesit

### **A siguron praktika që shërbimet e saj të jenë të aksesueshme për grupe të ndryshme?**

- Siguron mundësi të barabarta për grupet e saj të synuara (gratë dhe burra të të gjitha moshave, lgbtiq+ në varësi të grupit të synuar specifik, personave me aftësi të kufizuara dhe nevojave specifike);
- Miraton një qasje gjithëpërfshirëse pjesëmarrëse, të integrimit gjinor, të diversitetit dhe të ndjeshme ndaj moshës;
- Siguron që barazia dhe diversiteti janë një pjesë thelbësore e mënyrës se si ofrohen shërbimet, duke marrë parasysh nevojat dhe kapacitetet e ndryshme;
- Ofron informacion përkatës mbi nismën në gjuhë dhe formate dhe kanale të ndryshme komunikimi, të përshtatshme për moshën, gjininë dhe diversitetin e audiencës së synuar;
- Bën rregullime të arsyeshme lidhur me mënyrën se si ofrohen shërbimet për të marrë parasysh nevojat e veçanta të grupit të synuar (p.sh. ofrimi i kujdesit ndaj fëmijëve për prindërit (e vetëm), rregullime specifike për personat me aftësi të kufizuara, ofrimi i shërbimeve fleksibël me orar fleksibël, mbështetje e përshtatur dhe joformale për refugjatët.

### **A përfshin praktika pjesëmarrjen aktive të shoqërisë pritëse?**

- E konsideron integrimin si një proces të dykahshëm dhe synon ndryshime edhe në anën e shoqërisë pritëse (sjellja, normat, institucionet);
- Parashikon një rol aktiv të shoqërisë pritëse në zbatimin e tij (p.sh. vullnetarët);
- Përfshin veprime për të mbështetur shkëmbimet me shoqërinë pritëse.



**A konsultohet praktika me përfituesit e saj dhe a i përfshin ata në vlerësimin, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit/masës?**

- Organizon aktivitete të rregullta konsultimi me refugjatët për të siguruar kontributet e tyre gjatë gjithë ciklit të programit, nga vlerësimi deri te vlerësimi;
- U jep përfituesve disa kompensime për të lehtësuar konsultimet;
- Ofron mekanizma të përshtatshëm reagimi për përfituesit që të shprehin në mënyrë të sigurt mendimet e tyre për cilësinë e shërbimeve.

## **2. DIMENSIONI: RËNDËSIA DHE KOMPLIMENTARITETI**

Treguesit

**A janë objektivat e praktikës të rëndësishme për nevojat e grupeve të synuara?**

- Identifikon dhe analizon nevojat e grupit të synuar (intervistat/grupet e fokusuara me grupin e synuar, kërkimet në zyrë, anketat).

**A përmbush praktika një hendek në mbështetje të integrimit?**

- Identifikon dhe analizon mangësitë ekzistuese për mbështetjen e integrimit dhe harton veprime për plotësimin e këtyre mangësive;
- Plotëson masat ekzistuese duke u mbështetur dhe koordinuar me to;
- Punon me përfituesit që nga fillimi për të zhvilluar një plan afatgjatë integrimi dhe për të lehtësuar kalimin në programet kryesore të mbrojtjes sociale, integrimit dhe përfshirjes.

**A mbështetet praktika te politikat, udhëzimet, paketat e instrumenteve dhe praktikat e mira në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar/të BE-së?**

- Përdor/i referohet udhëzimeve dhe instrumenteve përkatëse në nivel kombëtar dhe të BE-së/ndërkombëtar.

**A na udhëheq praktika drejt një përmirësimi sistematik, duke adresuar nevojat e shumicës së grupit të synuar në zonën e synuar?**

- Kontribuon për forcimin e kapaciteteve të refugjatëve/komuniteteve të tyre;
- Kontribuon për forcimin e kapaciteteve të institucioneve përkatëse për të mbështetur integrimin (p.sh. ndryshimin e politikave apo strategjive; reformat legjislative; reformat institucionale; reformat e qeverisjes; rritjen e llogaridhënies për shpenzimet publike; ose përmirësimin e proceseve për konsultime publike);
- Trajton diskriminimin dhe mangësitë e informacionit si pengesa për integrimin afatgjatë;
- Praktika është e shkallëzueshme dhe përfshin plane konkrete për zgjerim.

### 3. DIMENSIONI: EFEKTIVITETI

Treguesit

**Deri në çfarë mase janë/ishin objektivat e praktikës realiste, të monitoruara, të vlerësuara dhe të arritura?**

- Arrin rezultatet e synuara me produkte dhe rezultate konkrete;
- Ka një kornizë të qartë rezultatesh që lehtëson matjen e rezultateve dhe ndikimit, me tregues të zgjuar;
- Rreziqet e mundshme janë përfshirë në hartimin e programit
- Mbledh sistematikisht të dhënat kryesore të performancës për monitorim dhe analizë të rregullt;
- Vlerëson dhe rishikon se çfarë progresi ka bërë praktika drejt arritjes së objektivave të saj;
- Analizon nëse ndërhyrjet e saj kontribuojnë për ndryshimet e qëndrueshme afatgjatë në integrim.

### 4. DIMENSIONI: QËNDRUESHMËRIA

Treguesit

**A i ka përdorur përfitimet e saj praktika pas përfundimit të projektit?**

- Përgatit dhe zbaton një plan të mirëpërcaktuar të daljes për të siguruar ndryshime të qëndrueshme pozitive dhe përdorimin e produkteve/rezultateve të projektit/masës.

**A tërheq politika fonde strukturore, mbështetje nga sponsorët e rinj, apo gjeneron burimet e veta?**

- Vendos partneritete dhe marrëdhënie me palët përkatëse të interesit si pjesë integrale e projektit për të siguruar mbështetje të fortë për të vazhduar pas përfundimit të financimit parësor;
- Diversifikon burimet e financimit dhe identifikon mundësitë e reja të financimit të BE-së dhe kombëtare për integrim afatgjatë (për shembull, zhvendosja ose planifikimi për të kaluar nga nismat e bazuara në projekte që janë të kufizuara në kohë, të varura nga një donator (i jashtëm), te një strategji integrimi gjithëpërfshirëse shumëvjeçare e bazuar te financimi i siguruar ose mundësi të ndryshme financimi);
- Siguron krijimin e burimeve njerëzore, ekspertizës dhe infrastrukturës për të mbështetur shërbimet në fund të projektit.

## 5. DIMENSIONI: PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI

Treguesit

**A ka praktika ndonjë strategji për të vendosur komunikim dhe koordinim me aktorë të tjerë përkatës për të nxitur integrimin e migrantëve? (p.sh. shoqërinë civile, autoritetet publike, sektorin privat)**

- Siguron përfshirjen dhe pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë në fazën e zhvillimit të tij;
- Zhvillon dhe zbaton një strategji për përfshirjen e tyre në projekt.

**A kontribuon praktika në diskutimet për përmirësimin e politikave mbështetëse të integritit?**

- Kontribuon për zhvillimin e strategjive gjithëpërfshirëse të integritit që përfshijnë autoritetet kombëtare/rajonale/vendore, ofruesit e shërbimeve dhe shoqërinë civile;
- Siguroni punën në koordinim me partnerët përkatës (autoritetet vendore, OJQ-të, partnerët social, kërkimin shkencor, institucionet, etj.) për të rishikuar së bashku operacionet, praktikatat, shërbimet dhe rezultatet e integritit.

Ky mjet vetëvlerësimi është përshtatur nga rrjeti i vlerësimit të MPG-së për iniciativën e Praktikave të Qëndrueshme të Integritit (SPRING), e cila ju lejon të shfaqni praktikatat tuaja të mira të testuara me kritere në një platformë evropiane. ([www.integrationpractices.eu](http://www.integrationpractices.eu)).

## 8. GLOSAR

**Azilkërkues:** azilkërkuesi është një individ që kërkon mbrojtje ndërkombëtare. Në vendet me procedura të individualizuara, azilkërkuesi është dikush, vendimi lidhur me kërkesën e së cilit nuk është marrë përfundimisht nga vendi ku ai ose ajo e ka paraqitur atë. Jo çdo azilkërkues njihet përfundimisht si refugjat, por çdo refugjat është fillimisht azilkërkues.

**Përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare:** Individët të cilëve u është dhënë tashmë statusi i refugjatit ose forma të tjera plotësuese të mbrojtjes. Ky Manual përdor fjalën refugjatë për të mbuluar të dyja kategoritë. Përfituesit e mbrojtjes plotësuese: sipas ligjit të BE-së, ata janë individë që nuk kualifikohen si refugjatë, por që përballeshin me një rrezik real për të pësuar dëmtime serioze nëse kthehen në vendin e tyre të origjinës dhe të cilët nuk janë në gjendje të marrin mbrojtje nga ai vend.

**Rrugët plotësuese:** Mjedise të sigurta dhe të rregulluara që plotësojnë vendbanimet e refugjatëve dhe me anë të së cilave refugjatët mund të pranohen në një vend dhe u plotësohen nevojat e tyre për mbrojtje ndërkombëtare, ndërkohë që ata janë në gjendje të mbështesin veten për të arritur potencialisht një zgjidhje të qëndrueshme dhe të qëndrueshme.

**Zgjidhje të qëndrueshme:** Mjetet me anë të të cilave situata e refugjatëve mund të zgjidhet në mënyrë të kënaqshme dhe të përherëshme përmes sigurimit të mbrojtjes kombëtare për të drejtat e tyre civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale.

**Diskutim në grup të fokusuar:** Një metodë për të mbledhur të dhëna/informacione cilësore nga një grup personash të parapërzgjedhur sipas kriterëve specifikë.

**I huaj:** Kjo kategori përfshin përgjithësisht të gjithë ata persona që janë larguar nga vendbanimi i tyre fillestar, përkohësisht ose përgjithmonë dhe për një sërë arsyesh të ndryshme.



**Praktikë e mirë:** Një praktikë novatore, interesante dhe frymëzuese që ka potencialin të transferohet tërësisht ose pjesërisht në kontekste të tjera kombëtare. Praktikrat e mira të përfshira në Paketën e Instrumenteve janë identifikuar duke ndjekur kriteret kryesore në secilin kapitull dhe pesë treguesit kryesorë të përgjithshëm: gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja; rëndësia dhe plotësueshmëria; efektiviteti; qëndrueshmëria; partneritetet dhe bashkëpunimi.

**Përfshirja:** Procesi i nxitjes dhe përmirësimit të pjesëmarrjes së refugjatëve në shoqëri, duke u dhënë atyre të njëjtat të drejta si qytetarët, duke krijuar lidhje dhe miqësi, duke qenë në gjendje të aplikojnë për punë vendore ose të shkojnë në shkolla vendore dhe duke pasur akses në shërbime të ndryshme si strehimi ose kujdesit shëndetësor. Plani i Veprimit për Integrimin dhe Përfshirjen 2021-2027 i Komisionit të BE-së thekson se “përfshirja për të gjithë ka të bëjë me sigurimin që të gjitha politikrat të jenë të aksesueshme dhe të funksionojnë për të gjithë, përfshirë migrantët dhe qytetarët e BE-së me prejardhje migrante. Kjo nënkupton përshtatjen dhe transformimin e politikave kryesore me nevojat e një shoqërie të larmishme, duke marrë parasysh sfidat dhe nevojat specifike të grupeve të ndryshme. Veprimet për të ndihmuar migrantët që të integrohen nuk duhet të jenë në kurriz të masave në përfitim të grupeve ose pakicave të tjera të cenueshme ose të pafavorizuara. Përkundrazi, ato kontribuojnë për t'i bërë politikrat më gjithëpërfshirëse në përgjithësi”.

**Integrimi:** Integrimi lokal në kontekstin e refugjatëve është një proces dinamik dhe i shumëanshëm i dykahshëm, i cili kërkon përpjekje nga të gjitha grupet e interesit, duke përfshirë gatishmërinë nga ana e refugjatëve për t'u përshtatur me shoqërinë pritëse pa pasur nevojë të heqin dorë nga identiteti i tyre kulturor, dhe një gatishmëri përkatëse nga ana e komuniteteve pritëse dhe institucioneve publike për të mirëpritur refugjatët dhe për të përmbushur nevojat e një popullsie të ndryshme (Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së, Përfundimi mbi Integrimin Lokal Nr. 104 (LVI) – 2005).

**Migrantë:** Njerëzit që kanë vendosur të lëvizin përtej kufijve ndërkombëtarë, jo për shkak të një kërcënimi të drejtpërdrejtë përndjekjeje, dëmtimi serioz ose vdekjeje, por ekskluzivisht për arsye të tjera, të tilla si për të përmirësuar kushtet e tyre duke ndjekur mundësitë e punës ose arsimimit, ose për t'u ribashkuar me familjarët e tyre.

**Të mitur:** Personat që janë nën moshë madhore sipas ligjit dhe për këtë arsye nuk janë ligjërisht të pavarur. Ky term përfshin adoleshentët. Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF), "fëmija" është një person që është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, përveç nëse ligji në fuqi përcakton një moshë më të ulët. KDF-ja e barazon "fëmijën" me "të miturin". Qasja pjesëmarrëse: Një qasje ndaj zhvillimit dhe/ose qeverisë në të cilën grupet kryesore të interesit (dhe veçanërisht përfituesit e propozuar) të një politike ose ndërhyrjeje përfshihen ngushtë në procesin e identifikimit të problemeve dhe prioriteteve dhe kanë kontroll të konsiderueshëm mbi analizën dhe planifikimin, zbatimin dhe monitorimin i zgjidhjeve.

**Personat me interes:** Të gjithë personat për të cilët UNHCR-ja është mandatuar të ofrojë mbrojtje, zgjidhje dhe ndihmë. Këtu përfshihen refugjatët, azilkërkuesit, refugjatët e kthyer, personat pa shtetësi dhe, në shumë situata, personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV), duke përfshirë ata që mund të marrin gjithashtu mbrojtje dhe ndihmë nga shteti dhe partnerë të tjerë.

**Mbrojtja:** Një koncept që përfshin të gjitha aktivitetet që synojnë arritjen e respektimit të plotë të të drejtave të individit në përputhje me shkronjën dhe frymën e të drejtave të njeriut, të refugjatëve dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare. Mbrojtja përfshin krijimin e një mjedisi të favorshëm për respektimin e qenieve njerëzore, parandalimin dhe/ose zbutjen e efekteve të menjëhershme të një modeli specifik abuzimi dhe rivendosjen e kushteve dinjitoze të jetës nëpërmjet dëmshtëpërlimit, kthimit dhe rehabilitimit. Refugjat: Një person që përmbush kriteret e pranueshmërisë sipas përkufizimit të zbatueshëm të refugjatit, siç parashikohet në instrumentet ndërkombëtare ose rajonale të refugjatëve, sipas mandatit të UNHCR-së dhe/ose në legjislationin kombëtar.

**Rivendosja:** Transferimi i refugjatëve nga shteti ku ata kanë kërkuar strehim në një shtet tjetër që ka rënë dakord t'i pranojë ata. Refugjatëve zakonisht u jepet azil ose ndonjë formë tjetër e të drejtave të qëndrimit afatgjatë dhe, në shumë raste, kanë mundësi të bëhen qytetarë të natyralizuar. Për këtë arsye, zhvendosja është një zgjidhje e qëndrueshme, si dhe një pako për mbrojtjen e refugjatëve. Ai është gjithashtu një shembull praktik i ndarjes së barrës dhe përgjegjësisë ndërkombëtare.

**Mandati i UNHCR-së:** Roli dhe funksionet e UNHCR-së siç përcaktohen në Statutin e UNHCR-së dhe siç është specifikuar në rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Mandati i UNHCR-së siç deklarohet në Statutin e saj është të sigurojë mbrojtje ndërkombëtare dhe të kërkojë zgjidhje të përhershme për refugjatët. UNHCR-ja ka një mandat shtesë në lidhje me çështjet e pashtetësisë, pasi i është dhënë një rol i caktuar sipas nenit 11 të Konventës së 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë. Zyrës i është kërkuar gjithashtu nga Asambleja e Përgjithshme të promovojë Konventat e 1954-ës dhe të 1961-it për pashtetësinë dhe të ndihmojë për parandalimin e pashtetësisë duke u ofruar shteteve shërbime teknike dhe këshillimore mbi legjislationin dhe praktikën e kombësisë.

**Të cenueshëm:** Persona të pafavorizuar në aspektin fizik, mendor ose social, të cilët mund të mos jenë në gjendje të përmbushin nevojat e tyre themelore dhe për këtë arsye mund të kenë nevojë për ndihmë specifike.



# 9. VLERËSIMI RRETH MANUALIT

*‘Ky manual është një mjet i dobishëm për të udhëzuar autoritetet vendore lidhur me planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e praktikave të tyre të integrimit dhe ofron shumë ide praktike se si të përfshihen drejtpërdrejt përfituesit në proces.’*

---

Katharina Bamberg, Këshilltare për Politikën e Migracionit dhe Integrimit në EURO CITIES

*‘Kjo paketë instrumentesh ofron udhëzime të dobishme për profesionistët e integrimit dhe përfshirjes, bazuar në parimet e fuqizimit, bashkëprojektimit, maksimizimit të potencialit të diversitetit dhe ndërveprimit ndërkulturor. Leximi i rekomanduar për profesionistët dhe vullnetarët e Qyteteve Ndërkulturore në mbarë botën.’*

---

Irena Guidikova, Shefe e Programeve të Përfshirjes dhe Antidiskriminimit, Këshilli i Evropës

*‘Autoritetet vendore dhe rajonale janë të rëndësishme për ofrimin e politikave të suksesshme të integrimit në terren, por ato shpesh lihen pa mbështetje kur bëhet fjalë për zbatimin e politikave të tilla. Manuali i Integrimit i UNCHR-së është një mjet i çmuar në këtë drejtim.’*

---

Antje Grotheer, raportere e Komitetit Evropian të Rajoneve (KER) për Paktin e Ri për Migracionin dhe Azilin dhe Zëvendës-presidente e Parlamentit të Qytetit të Bremenit në Gjermanisë

Mandati i UNHCR-së: Roli dhe funksionet e UNHCR-së siç përcaktohet në Statutin e UNHCR-së dhe siç është përcaktuar në rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Mandati i UNHCR-së, siç deklarohet në Statutin e saj, është të sigurojë mbrojtje ndërkombëtare dhe të kërkojë zgjidhje të përhershme për refugjatët. UNHCR-ja ka një mandat shtesë në lidhje me çështjet e pashtetësisë, pasi asaj i është dhënë një rol i caktuar bazuar në nenin 11 të Konventës së vitit 1961 mbi Uljen e Pashtetësisë. Zyrës i është kërkuar gjithashtu nga Asambleja e Përgjithshme të promovojë Konventat e pashtetësisë të vitit 1954 dhe 1961 dhe të ndihmojë për parandalimin e pashtetësisë duke u ofruar shteteve shërbime teknike dhe këshillimore mbi legjislacionin dhe praktikën e kombësisë.



